

E Kadareja? Ai është me Mandelshtamin në mungesë në këtë libër-apologji

**MBRESË NGA LEXIMI I PARË I VEPRËS MË TË
FUNDIT TË KADARESE "KUR SUNDUESIT GRINDEN"**

Nga VISAR ZHITI

(Fq. 2)



EDITORIAL

**PANAIRI I LIBRIT
MUND TË JAPË VETËM
ÇMIMIN E KARRIERËS.
JO SI DERI MË SOT**

Nga BUJAR HUDHRI

(fq. 2)


**MARTIN
CAMAJ
POEZI**

(Fq. 8-9)



**TEATËR
REALITETI I SOTËM
SHQIPTAR I MBETUR
"JASHTË DERËS" SË
BORHERT**

(Fq. 14)




MERR ÇMIMIN E KARRIERËS NË PANAIRIN E LIBRIT

INTERVISTË EKSKLUZIVE

KIM MEHMETI

**Shkurt e shqip: epoka
ime krijuese do varet
nga ajo jetësore**

(Fq. 4)



KRITIKA

Për një roman pikaresk dualitetesh

Nga Arian Leka

(Fq. 10)

Antiutopia e Mehmet Krajës

Nga Bashkim Kuçuku

(Fq. 11)



110 vjet Kongresi i Manastirit

**Zbulohet origjina e
panjohur e Himnit të
Alfabetit**

Nga David Hosaflook

(Fq. 12)

**Fituesi i Panairit të Librit
BRAJAN SUKAJ:**



**Mundohem
të pikturoj
me fjalë,
atë që
përfytyroj**

Intervistë me
autorin e ri,
për romanin
"Ciklopi"

(Fq. 6)

EDITORIAL

PANAIRI I LIBRIT MUND TË JAPË VETËM ÇMIMIN E KARRIERËS.JO SI DERI MË SOT

Nga BUJAR HUDHRI

Prej disa vjetësh kryesia e shoqatës së botuesve jep ditën e fundit të panairit disa çmime: për librin më të mirë nga letërsia shqipe, përkthimin më të mirë, letërsinë për fëmijë..

Por cila është procedura e dhënies së çmimeve.? Cili libër mund të fitojë çmimin e vitit? Për këtë po sjell në vëmendjen e lexuesit udhëzimet që vijnë nga sekretaria e shoqatës. Ja, tekstualisht:

“E drejta për konkurim u jepet vetëm botuesve që janë pjesëmarrës në panair. Do të përfshihen në konkurs të gjitha botimet pas Panairit të 20 të Librit (domethënë dhjetor 2017-nëntor 2018). Data e botimit duhet të vërtetohet nëse është e fundvitit 2017.”

Pyetja e parë, që del natyrshëm, është: si mund ta vërtetosh që ky libër është botuar në fund të vitit 2017?! Në të gjithë kohërat, në të gjitha gjuhët shënohet vetëm viti i botimit. Nuk ka një shenjë apo symbol tjetër që ta saktësojë ditën e javës, apo muajin e vitit kur del një libër. Sepse libri nuk është gazetë, apo jo?

Problemi tjetër që duket i pamundur të zgjidhet është se deri kur pranohen më librat për konkurim. Ja njoftimi që vjen nga kryesia e botuesve:

“Lutemi që të gjithë të interesuarit (pjesëmarrës në Panair) të dorëzojnë deri në datën 31 tetor nga një kopje të librit/librave që ata propozojnë për çmim. Libri duhet të jetë botuar detyrimisht brenda kësaj date. Libri ose librat që do konkurrojnë për çmim duhet të dorëzohen në sekretarinë e Panairit brenda kësaj date nga Botuesi, Autori apo Përkthyesi. Gjithashtu mund të dorëzohen libra edhe në formë elektronike apo dorëshkrim, por me kusht që të dorëzohet në formë librorë deri më datë 31 tetor 2018.”

Pyetja që mund të shtrohet në këtë rast është thjeshtë. Nëse ditën e 31 tetorit vijnë 10 apo 20 apo kushedi se sa romane në dorëshkrim, a do t'i lexojë dot juria e përbërë prej katër vetash? A ka mundësi reale që t'i lexojë juria një për një, për të gjetur fituesin e merituar? Absolutisht që jo. A e di juria dhe kryesia e botuesve? Sigurisht që po. Dhe kjo histori e çuditshme vazhdon prej vitesh. Pra, librat nuk lexohen, por çmime jepen. Po si, në ç'mënyrë? Me çfarë ndërgjegje profesionale?

Do të fitonte shumë libri shqip, nëse këto çmime, tani e tutje, të mos jepeshin më.

I vetmi çmim që mund të jepet dhe është në nderin e Panairit të Librit të Tiranës, ky është vetëm një dhe quhet Çmimi i Karrierës për Autorin e Letërsisë Shqipe.



3 minuta bisedë, madje në telefon, tre çerek shekulli më parë dhe larg në një tjetër vend, ka zgjedhur shkrimtari Kadare për të shtjelluar në veprën e tij më të fundit, “Kur sunduesit grinden”, që s'është thjesht roman, as memuaristikë, as sprovë, as kritikë, as..., por të gjitha këto së bashku, një vepër e veçantë marramëndëse, e tij dhe e pangjashme, me një sharm shqetësues.

3 minuta bisedë mes dy sunduesve, Stalinin dhe Pasternakut, i pari mbi një vend të madh dhe ndër më gjakatarët e historisë njerëzore, kurse i dyti, sipas Kadaresë, sundues i shpirttrave njerëzorë të atij vendi, të së njëjtës kohë, pra shkrimtar i madh.

Çfarë u bisedua në ato 3 minuta të famshme, që përthithën aq shumë vëmendje e vazhdojnë të përthithin? Stalini merr në telefon Pasternakun dhe e pyet për një shokun e tij të arrestuar, poet dhe ai sa ai, Mandelshtami, dhe Pasternaku i hutuar pak a shumë i përgjigjet se ne/ata jemi/janë të ndryshëm, gati s'njiheshin, duke sikur donte të thoshte a e tha dhe diktatori si i zemëruar ia kthen se nuk mbrohen shokët kështu dhe ia mbylli telefonin, duke u hapur pas kësaj komentime të pafundme gjithandej, variante të bisedës së pakët, që gati s'mund të quhet e tillë, e pa përfunduar, me hamendësime që do të vazhdonin dhe sot e kësaj dite, siç na siguron Kadare duke u futur dhe vetë, si atij që i takon, në ato përsiatje tani.

Vërtet Stalini donte të mbronte Mandelshtamin nga Stalini? A mundej dot Pasternaku?

3 minuta dhe trashja infernale: diktatori & shkrimtari i njohur & i pa pranishmi - shkaktari i bisedës. Po ç'ishte ky? Poet i porsa arrestuar që do të përfundonte burgjeve dhe harrimeve, do e vrisnin a do të vriste veten, e njëjta gjë, por që a do të mund të rikthehej fantazmë.

Dhe tek të tre këta, autori i këtij libri, sovranshëm, që kërkon të shtjellojë, të ribejë tufanin.

Gati një shekull sundim i perandorisë komuniste, pothuaj gjithë shekulli XX në një hapësirë të pa masë dy kontinenteshe, Europë dhe Azi, por dhe përtej oqeanit, në Amerikë, me 100 milionë viktima në të gjithë botën, sipas statistikave, me pushkatime e burgje e çmendje lemerisëse, baltë internimesh e zhdukje mizore, terror dhe frikë dhe uri, ankth, punë rraskapitëse e luftë, fitore të mëdha që janë ndërkohë dhe humbejet më të mëdha, entuziazëm që duket si një marrëzi kolektive, monumente dhe fabrika të zymta, klasë punëtore dhe artistë të trallisur, që duhet të jenë shërbëtore të tyre, konflikte dhe letërsi të detyruar të Realizmit Socialist, lumturi dhunuese e paqenë kurrë lumturi, etj, etj, dhe midis miliarda rënkimeve e britmave të gojëve të çaplyera dhe plagëve, fyteve të prera, mallkimeve,

pëshpërimave, përbetimeve, të folurit nën zë, me vete, të gulçeve me dheun përsipër, grindjeve me gardianë, policë, redaktorë e sekretarë e mes vetë të persekutuarve, mes vëllezërve Abelë e Kainë, atit dhe birit dhe vetes, etj, etj, etj, që po t'i mblidhje nëpër burgje e kampe internimesh si kohë, mund të bënin shekuj, mijëvjeçarë dhe befaz Kadareja, si trillan fantast që është, në këtë zallamahi botërore, zgjedh sfidueshëm vetëm tre minuta bisedë, as të vendit të tij e as të gjuhës së tij.

Aty jo vetëm që ndihet, por sipas tij, është shumëçkaja, nuklea, një mister kundër mistereve. Si shkrimtar i pa shoq, i intereson qendra, të cilën e fikson vetë, nga aty ku zanafillojnë ato që do të ndodhnin gjithandej, mes shteteve dhe njerëzve, fikshën dhe jo fikshën, sepse kemi të bëjmë dhe me realitetin tjetër, atë të shkrimtarëve, deri dhe të vetmitarëve të tyre e më tej, përfshi adulterët, more dhe shtratin bashkëshortor a arkëmortet e jo llogoret e kanalet e dënimeve në ferr, prangat dhe plagët e pushkatimeve.

Kadare zgjedhi si vend të veprës më të fundit duke iu rikthyer sërish, Moskën, kryeqytetin e Bashkimit Sovjetik, ku dhe ka qenë student, në fakt dëshmitar.

Po kështu Kadaresë duket se i ka interesuar gjithmonë e larta, lartësitë, pa shkuar te qielli, aq sa mund të mbikqyrësh zotërueshëm shumëçka dhe zgjedhi tani kështjellën, Kremlinin me Stalinin brenda si një murg të rrezikshëm dhe pak më tej një apartament të Moskës, me Pasternakun brenda, “inxhinierin e shpirttrave”.

Nga gjithë ajo truallnajë trallisëse euro-aziatike e perandorisë komuniste, Kadaresë i mjafton tani fare, fare pak, aq sa ç'është afëria mes dy banesave të tyre, që, të para nga sateliti lart, do të përbënin, jo vetëm ato, por e gjithë Moska, veçse një pikël të vetme mbi zhgual të globit. Dhe mes miliarda e miliarda bisedave njerëzore të pafund, qoftë dhe të një dite, thashethemeve dhe intrigave globale, ofshamave të popujve që duket sikur ato i kanë krijuar retë përsipër tyre, Kadare, sipas llogjikës noprane të shkrimtarisë, siç e pamë, zgjedh vetëm tre minuta bisedë, një kampion të ajërt, ato pak fjalë të sikletshme që shkëmbyen mes tyre Stalini e Pasternaku, me telefon tre çerek shekulli më parë.

I mjafton kjo. Një marrëzi gjeniale për një shkrimtar, e prapshtë ndërsa, ndërsa për lexuesin habitëse në mënjanësinë e saj, ankthëruese gjithësesi gjatë leximit, por që kanë përfutur një vepër letrare çudane, të papërsëritshme, e karuseltë, torturuese në rrotullimin e saj, me personazhë realë, që takohen, duan, ndahen, përloten, vdesin, harrohen.

Nxitoj të them atë që do të duhej të thuhej e para, vepra i shërben copërlueshëm kujtesës njerëzore,

VISAR ZHITI: E Kadareja? Ai është me Mandelshtamin në mugesë në këtë libër-apologji

më të paktës - asaj elitare, në fund të fundit gjithë atij mekanizmi sa të ngadaltë e të përpiktë, po aq dhe ndëshkues, qoftë dhe në ndërgjegje, ndërkohë paqtues duke ngulmuar t'i vërë gjërat e kësaj bote në vendet e tyre, ato që do t'i duheshin, teksa harresa është djallëzisht katastrofike.

Me takt acarues nën një qetësi të kadifenjtë, sa ç'ia kërkon estetika e veprës, Kadare tek e vogla ndrydh të madhen, vetë hatanë nga drama e përbotshme. Te minimumi vë maksimumin, pra është autor i minimakseve, do të thosha duke huazuar një kompozitë të huaj. Vepra i ngjan një hetimi lodhës, ku lodhja këtu është e pa lodhshme, ku nga e rëndomta shkohet te sublimja, me atë magjinë kadareane, herë herë me seriozitet të zymtë e më pas me ironi groteske. E qeshura është plagosëse.

Një libër i vështirë-rrokshëm, i ngjan shakujve të erës te poemat homerike, te "Odisea", që kanë të ndrydhur erë brenda, më të pa përfshirshmen, më të pa përshkrueshmen dhe çmitikisht i është dale, shakulli është hapur duke përplasur erë fytyrave, me qëllim, që duket sikur ky është dhe qëllimi artistik, se prandaj është krijimi dhe e më pastajmja... Paralelizmat janë kuptimplote, autori diku nga fillimi kujton dhe vetë telefonatën e diktatorit Hoxha me vetë Kadarenë, të cilin do ta përgëzonte për një poemë të tij dhe unë, nga emocioni i leximit e jo vetëm, marr të drejtën ta vazhdoj ose ta ribëj bisedën. Edhe Enver Hoxha e mori në telefon Kadarenë në fakt për ta pyetur se ç'mendim kishte, jo për kolegët shkrimtarë, që i çuan burgjet, as për poetët që do të pushkatonin, Trifon Xhagjika, Vilson Biloshmi e Genc Leka, as për Havzi Nelën, që e varën etj, ai s'donte mendim për ta, por, më djallëzisht akoma, se ç'mendim kishte Kadare për Kadarenë që do të shkruante "Ura me tre harqe", "Pallati i ëndrrave", Koncerti...", etj. Dhe Kadareja do të jetë hutuar, por që të mbronte veten e ardhshme, duhej të hutonte disi diktatorin, më djallëzisht akoma, me lëvdatën e mynxyrshme. Dhe Hoxha ka vazhduar: që të të mbroj, më mbështet... pa ia thënë kaq troç, duke e lënë të nënkuptuar si goditjet pas buzëqeshjeve tiranike. Të thoshte "jo" Kadareja, ishte tmerrësisht e rrezikshme, ishte fundi, por dhe "po"-ja, kishte po aq rrezikun e mëvonshëm, post-hoxhist. Të ketë guxuar ta ketë mbyllur telefonin Kadareja, gjoja nga tronditja apo që nuk ka parë mirë, dhe pa dashje... dhe...

Përgjigjen e dha koha dhe vepra kadareane. Enver Hoxha u kundërshtua... dhe vepra më e fundit e Kadaresë vazhdon dhe pasi e mbaron së lexuari, me atë shtysën misterioze e të brendshme të saj. Nën ndikimin e asosacionit të ideve po më nëpërmendej një version shtesë i krerëve të veprës,

kjo është magjia e saj, që vazhdon te lexuesi, i katërmbedhjetë, p.sh., me një grua sërish, jo në Moskë, por në Tiranë, një nënë, imja, që ndal Kadarenë dhe i lutet për djalin që ia kanë arrestuar ngaqë donte të shkruante poezi dhe përgjigjja e Kadaresë dhe letra prekëse e Tij nga Parisi më pas dhe falenderimi im edhe tani, pas 27 vitesh.

Autori përmend burgun e Petro Markos, unë shtoj dhe burgosjen e djalit të atij, poet dhe ai dhe sakrificat e përçudnuara të nënës, Safos për ta liruar me doemos si version të pesëmbëdhjetë.

I kthehem dhe një herë librit që kemi. Diktatori gjakatar Stalini i telefonoi shkrimtarit më të njohur të vendit, Pasternakut, dhe e pyet nëse dëshiron ta ndihmojë një kolegun e tij, mik, që po e dënonte vetë Stalini dhe Pasternaku i hutuar nuk e mbron dot nga ai që po ia ofron ndihmën vrastare. Paradoks tragjik. Çelës për të hapur e gjykuar gjithë marrëdhënien, realen, të dukshmen mes diktaturës e shkrimtarit të saj. U zbut kështu sundimtari gjakatar apo kërkon bashkëpunëtor, sundimtarin tjetër, të ndryshëm nga vetja, atë të shpirtave që ai nuk e beson, shkrimtarin?

Kurse i treti, nuklea e asaj bisede të mallkuar, Mandelshtami, është i pa qenë, ashtu duan ta bëjnë me mjete sa më barbare, e kanë arrestuar dhe po e nxjerrin nga realiteti, po e çojnë në tjetër kundër-realitet, në atë jo për të gjithë, por për një pakicë të shenjuarish, të përzgjedhurish që një djall e di se për ç'arsye, po e mbyllin në burg, në vdekje më pas, që ishte fare afër me burgun, mjafton të kaloje telat me gjëmba e nuk dilje i lirë në realitetin e lënë, por rrëzoheshe përfundimisht në humnerat e Hadit.

Mandelshtamët donin t'i zhbënin. Ata

nxirreshin nga beteja ashtu si dhe nga jeta prej sundimtarit të parë, Stalinit, pa u mbrojtur dot nga sundimtari tjetër, Paternaku. Që më pas të ktheheshin si fantazmë, por më të fortë se më parë, kur të përmbyses, më saktë kur përmbysja t'ia linte vendin një gjendjeje normale, afërsisht, a që tentohej drejt saj deri sa dhe ajo vetë të bëhej për t'u përmbysur.

Kufoma e Stalinit do të nxirrej nga mauzoleu e do të digjej, por dhe kufoma prej bronzi e Enver Hoxhës do të shkulej nga piedestali e do të copërlohej. Ata s'duhej të ishin lejuar të bënin aq sa bënë, gjëmën e përgjithshme...

Po Pasternaku? Që s'e mbrojti dot shokun, gjysmën e vetes? Apo duke qenë si njëllot tjetër sundimtari, gjysmën tjetër e kishte peng te Stalini? Që të mbronte veten që s'ishte as Stalini e as Mandelshtami, por një nevojë urgjente e kohës. Dhe mbase duhet ta mësojmë veten që të mos t'i kërkojmë tjetrit më shumë, por aq, të bënte më mirë atë që mund të bëhej. Se heshtja nuk është letërsi.


E Kadareja? Ai është me Mandelshtamin në mungesë në këtë libër-apologji.

Në fund të fundit gjithkushi do të mund ta dëshmojë veten e vet, nuk e bën askush tjetër. Dhe vetja është te tjetri dhe tjetri te vetja.

Stalini prijëtar me krimet e veta, Pasternaku me librat e tij, me poezinë, që mbetet dhe Mandelshtami me zhdukjen po aq shumë se sa me veprën që mundi të shkruajë, me poezinë që mbetet dhe te ky, por dhe me atë që nuk mundi të shkruajë, që s'e lane e që s'dihet nën ç'shakull homerik është futur. Dhe vazhdoj me fjalët përmbyllëse të Kadaresë, "Osip Mandelshtami as ka qenë, as do të jetë ndonjëherë i vetuar në largësinë e vet. Dhe këtu qëndron, me sa duket, ajo që, për të shmangur fjalën e bujshme 'pavdekësi', do ta kishim më lehtë dhe më natyrshëm për Mandelshtamin dhe për të gjithë të ngjashmit e tij, fjalën 'pafundësi'".

Fundi është pafundësia. Edhe ky libër sikur do të na mësojë dhe me këtë. Por, që para se të jetë e parrokshme dhe universale, le të bëhet dhe ngushëllim i shenjtë, drejtësi patjetër, pse jo e shenjtë dhe kjo.

Kërkesa e autorit, bërë botuesit për mundësinë e një botimi tjetër të plotësuar të këtij libri, edhe pse ndokujt i ka krijuar gjendje keqardhjeje, madje dhe mërzie, unë e gjej si një shenjzë letrare të gjetur, së pari autori është i singertë me lexuesin, por dhe një lloj "ftese në studio"-n e Tij, ndërkaq mendoj se libri mjafton si i tillë, e ka dhënë veten, me një lloj pengu, që e bën të pa shtershem merakun e bukur, se tek e fundit prandaj bëhet dhe një libër tjetër, vetë letërsia deri në "pafundësi".



Kadare, sipas llogjikës noprane të shkrimtarisë, siç e pamë, zgjedh vetëm tre minuta bisedë, një kampion të ajërt, ato pak fjalë të sikletshme që shkëmbyen mes tyre Stalini e Pasternaku, me telefon tre çerek shekulli më parë.



Kim Mehmeti është vlerësuar në panairin e Librit që u zhvillua në Tiranë me çmimin e karrierës, duke prezantuar në këtë edicion edhe kompletin e tij letrar. Në intervistën ekskluzive për “ExLibris” shkrimtari rrëfen raportin jo të lehtë me të qenit krijues dhe njëkohësisht i angazhuar, në çfarë historia trashëgon nga e kaluara. Romani “Pusi” është një pjesë e thellë kësaj jete...

Kim Mehmeti

Shkurt e shqip: epoka ime krijuese do të varet nga ajo jetësore

Intervistoi: Violeta Murati

-Merrni në Tiranë çmimin e karrierës, pasi keni garantuar sigurinë e prezencës letrare këtu, praninë. Përveçse vlerësimit, çfarë ju shtyn të reflektoni?

K. Mehmeti: Nuk jam i çmimeve dhe nuk mund të lëvdohem se i kam të shumtë. E çmimet janë një lloj ‘falënderimi’ publik për atë që ke dhënë gjatë ndërtimit të botës tënde krijuese, e cila botë ka mundur ta begatojë edhe atë të atyre që i kanë lexuar veprat tua.

Mendoj se gënjen ai që thotë se për të nuk kanë asnjë rëndësi çmimet, ngaqë për mua ka rëndësi edhe falënderimi i një lexuesi të vetëm, e le më ai i një grupi lexuesish profesionist, siç janë anëtarët e një jurie. Çmimet duhet të jenë atë që në të shpeshtën e rasteve të ne nuk janë: tregues që të çojnë drejt vlerave të mirëfillta letrare. Pastaj çmimet duhet të përcaktojnë edhe atë që rrallë herë e arrijnë çmimëdhëniet të ne: të garantojnë jetëgjatësinë e veprave që shpërblehen.

Për mua çmimi i vlefshëm është edhe vetë prezenca e veprave të mia në hapësirat mbarëshqiptare. Pra çmimi i veçantë është prezenca ime aty ku janë ‘Piemontët’ e artit dhe kulturës shqiptare: në Tiranë e Prishtinë. Prandaj si krijues nga jashtë kufijve të mëmëdheut, për mua ka shumë rëndësi vlerësimi që ma bëhen në mëmëdhe.

Kuptohet, çmimet mundet për një çast të të bëjnë të dukesh më shumë seç je, por është mirë që të mos e humbësh baraspeshën, e të mbetesh aq sa je. E thash se nuk jam i çmimeve, por e kam ndje befasinë e këndshme të ndarjes së tyre. Kur e them këtë, kam parasysh se kur m’u dha çmimi ‘Rexhai Surroi’ në Prishtinë për romanin më të mirë të vitit 2007, e morra vesh se ai do më ndahej kur hyra ngutshëm në sallën ku ndaheshin çmimet, ngaqë isha i ftuari i vetëm i vonuar.

Ndërkaq, tani kur m’u nda çmimi i fundit, atë e mora vesh në çastin kur doja të dilja nga salla ku porsa kishte përfunduar promovimi i kompletit të veprave të mia dhe kur më thanë se nuk duhej ta braktisja sallën. Përderisa rrallë herë kam marrë çmime, shpeshherë kam qenë anëtar jurie edhe të çmimeve rajonale. Dhe nga përvojë si ‘jurist’ i disa çmimeve, e kam kuptuar se mbase do ishte mirë sikur të ndaheshin aq çmime sa botohen vepra brenda vitit dhe të kishte aq juri sa edhe shije lexuesish. Ngaqë libri i botuar, nëse për askënd tjetër, është i vlefshëm dhe më i miri i botuar gjatë vitit për autorin që e ka shkruar. Dhe se çdo lexues, e ka shpallur fituesin e vet nëpërmjet leximit të veprës së tij.

-Për vitin 2002 ju shkruani vetëm shqip, si rezistencë

e rebelim ndaj autoriteteve politike të Maqedonisë, edhe pse keni treguar se jeni ndjerë mirë me letërsinë tënde, ashtu siç është çmuar edhe në Serbi. Me këtë tregoni për herë të parë se pretendon, ose siç i keni premtuar vetes, të jeni në Tiranë, dhe vlerësimit nga kjo qendër, duke e çmuar si qendër prej nga duhet bërë çertifikimi i vlerave kulturore mbarëshqiptare. Ja ku jemi me profecinë tuaj... sot, çfarë peshe ka?

K. Mehmeti: Jam në moshë kur e ndiej se sa dora e jetës më ka përkëdhelur, e sa më ka gërvishur. Pastaj jam në moshë kur jo rrallëherë më ndodh ta rishikoj udhën që kam ecur. Dhe ndjehem mirë kur vërej se ai ka qenë rrugëtim që nuk më bën të pendohem për asgjë.

Që nga viti 2002 shkruaj vetëm shqip, sepse atë vit publikisht e thashë se nuk do shkruaj në gjuhën maqedonase përderisa në Maqedoni nuk zyrtarizohet gjuha ime amtare. Ky vendim imi nuk kishte të bëjë me qëndrimin tim ndaj gjuhës së bashkëqytetarëve të mi sllavo-maqedonas, por ndaj një ngrehine shtetërore që mohon dhe nënvlerëson gjuhën shqipe.

Kurrë nuk e kam mohuar të vërtetën se fillimet e mia letrare janë në gjuhët sllave. Kjo falë fatit tim jetësor që të jetoj në mjedise joshqiptare dhe të shkollohem në gjuhët joamtare. Dhe ky ‘jeniçerizëm’ imi kulturor, nuk më bën të ndjehem as i shpërblyer, as i ndëshkuar, ngaqë ‘jeniçerizmi’ është çështje fati, e jo çështje zgjedhjeje.

Por qysh i ri e kisha të qartë se nëse ke mundësi, është mëkat të mos i kthehesh ‘atdheut’ tënd gjuhësor. Dhe se është e turpshme të mësosh deri në përsosmëri gjuhë të huaja, e ta kesh lënë në harresë gjuhën e qumështit të nënës. Andaj edhe bëra çmos t’i kthehem gjuhës së ninullave të nënës dhe ‘certifikatën’ krijuese ta marr aty ku duhet të më jepej – në tërësinë mbarëshqiptare. Por kuptohet – duke mos u vetëgënjyer se lehtë arrihet që të bëhesh pjesë e rafteve të bibliotekës kombëtare... Dhe ja, tani jam këtu ku më thonë se e kam vendin. E unë ndjehem mire, aq mirë sa mund të them diçka që mbase nuk i ka hije një shkrimtari: letërsia më ka ofruar më shumë seç kam pretenduar dhe ndjehem i plotë.

-Pas karrierës është një investim letrar, pra korpusi apo kompleti letrar që e prezantuat në panairin e librit në Tiranë, për të cilën ju thoni se pëshpërit të vërtetën e njëjtë. Cilën?

K. Mehmeti: Që nga dita kur filloi përgatitja e këtij kompleti, fillova të ndjehesha si ai të cilit tani ia kompletonin portretin krijues, me çka do shihej fytyra e tij e plotë si shkrimtar. Dhe ndoshta prandaj nuk më hiqej nga mendja thënia se vetëm gjatë fëmijërisë dhe

rinisë, njeriu jeton me fytyrën që ia ka dhënë Zoti dhe se, gjatë jetës së mëtejme, duke shpresuar dhe duke synuar të arrijë të ëndërruarat, ai në të vërtetë e zgjedh fytyrën e pleqërisë dhe atë me të cilën do të vdesë. Me çka më egërsisht se kurrë më parë, m’u sforcua bindja se njeriu lind e rritet me fytyrën që ia ka dhënë Zoti, por plaket e vdesë me fytyrën që e ka zgjedhur për vetveten – me atë të turpit, apo atë të njerëzores. Me çka pra më rritej shpresa se e kam jetuar ndershëm edhe jetën time krijuese dhe se sadopak, si njeri e krijues, nuk kam fytyrë të shëmtuar!


Po pra, rrjedha e përgatitjes së kompletit të veprave të mia, më përballi me gjatësinë e rrugëtimit jetësor e krijues që kisha kaluar. Dhe ma rikujtoi nismën e atij udhëtimi. Kështu që m’u kujtua botimi i librit të parë, i të dytit dhe i të gjitha veprave të pastajme si dhe, të gjithë atë që atyre ua dhashë dhe që ato më sollën. Gjatë rikujtimit të këtij udhëtimi jetësorë e krijues, përnjëherë m’u qartësua se njësoj si fëmijën që e çojnë drejtë rritës së tij duke e gënjyer me dhuratat që do ia blejnë të nesërmen, edhe të rriturit, ecin gëzueshëm drejt pleqërisë dhe vdekjes, duke u vetëgënjyer me sukseset që do i arrijnë nesër, e madje, nëse janë shkrimtar, edhe me ditën kur do ua botojnë kompletin e veprave të tyre!

-Pas ’90-ës kur ne “rrëzuan” komunizmin, libri ishte komunikimi më i vështirë për botën shqiptare në këtë rajon. Nuk më hiqet nga mendja kur thonit në fillim të viteve 2000 se ishit të detyruar të kalonit kufirin ma ca libra në trajse... Ishit këmbëngulës. Rebel kur flisnit pse lihet jashtë periferia letrare. Çfarë ka qenë kjo trajektore, kjo ligjëratë e gjatë disaveçare drejt “qendrës”, a kemi ende të njëjtën ‘sëmundje’?

K. Mehmeti: Jam fëmijë i socializmit jugosllavë dhe i rritur gjatë viteve kur ne shqiptarët e Maqedonisë ndjeheshim si popull pa atdhe, si pjesë e një populli që vetvetes i kishte ngritur mure të lartë ideologjik, me çka e jetonte fatin e vëllazërisë së ndarë. Dhe zëri e largët që vinte nga matanë kufirit, i ngjante thirrjes së mallit për ta parë mëmëdheun, për ta njohur tërësinë e vëllazërisë shqiptare. Në ndërkohë lexoja pandalë në disa gjuhë sllave. Po pra, përderisa e njihja tërësinë e letërsive të popujve sllave dhe asaj botërore, shumë pak e njihja letërsinë e popullit tim. Gjë që normalisht të frustron. Librit të botuar në Tiranë, i ishte e ndaluar që të vinte deri te ne nga kjo anë e kufirit. Pastaj, si të ishte drogë, apo armë vdekjeprurëse, po ta zbulonin se në bibliotekën tënde ke ndonjë libër të ardhur nga Shqipëria, mund të përfundojë edhe në burg.

Dhe prandaj libri në gjuhën shqipe i atyre kohëve, ishte





diçka e çmuar, që e mbanim nën sqetull, aty ku ruhen sendet vlefshme, që nuk guxon t'i zbulojë askush.

Edhe sot, më ndodh të ndjehem keq kur e shoh se nëpër 'Shqipëritë' tona, më lirshëm qarkullon droga, se sa libri i botuar nëpër qendrat shqiptare. Por tani jo pse këtë na e ndalon dikush, por pse jetojmë në shtete ku është thuajse a pamundur ta kuptosh se vallë burrështetasit tanë e kontrollojnë krimin, apo kriminelët i kontrollojnë shtetet. Dhe pse ka filluar të na pëlqejë të jetojmë të ndarë nëpër principatat tona politike, letrare e kulturore. Kemi filluar pra të ndjehemi të vetëmjaftueshëm e të vetëkënaqur nëpër 'mëhallat' tona krijuese e kulturore.

Ku ta dish, ndoshta ne ende nuk e kemi rrënuar muret që dekadat e socializmit i vulosën në mendësinë tone, dekada gjatë të cilave na ndante muri i lartë dhe i patejkalueshëm ideologjik që ia ngritën shqiptarisë Enver Hoxha e Titoja. Dhe ndoshta do duhet të presim të vijë një gjeneratë e re, e cila do e kuptojë se kultura e një populli të ndarë dekada me radhë, do mund të integrohet në atë evropiane apo botërore vetëm pasi të jetë 'integruar' brenda vetvetes.

Si mbani mend fillimet, kur keni nisur të shkruanit letërsi?

K. Mehmeti: Nuk kam ndonjë rrugëtim 'normal' krijues ngaqë gjatë jetës kam pasur shumë shëtitje nëpër

botë e nëpër profesione. E vetmja që më ka shoqëruar gjithmonë nuk ka qenë shkrimi, por leximi. Nuk u takoj krijuesve që të gjitha ia kanë përkushtuar krijimtarisë, ngaqë rrugëtimi imë jetësor herë më largonte e herë më afronte pranë shkrimtarit në mua. Andaj e them se gjatë rinisë, shkrimtarin në mua, e mbante gjallë lexuesi - pra leximi, e jo shkrimi.

Pas shkrimeve të para të botuara nëpër revistat jugosllave dhe në vitet e rinisë së hershme, pasoi një ndarje shumëvjeçare me krijuesin në mua. Shkrimi iu riktheva në moshën thuajse të pjekurisë, kështu që librin e parë e kam botuar në moshën tridhjetëvjeçare. Dhe pastaj çdo gjë është pjesë e jetëshkrimit tim, ku bënë pjesë ardhja ime në botën gazetareske shqiptare, si dhe veprimtaria ime si redaktor i revistave kulturore dhe kolonave të librave. Kur bëhet fjalë për fillimet e mia krijuese, nuk mund të mos e rikujtoja takimin e parë me idhullin e viteve të mia rinore - me Anton Pashkun! Me të u takova në vitin 1986, kur u ngjita në katin e nëntë të Pallatit të Shtypit, apo të Shtëpisë Botuese Gazetareske "Rilindja", e ku ndodhej edhe zyra e tij. Kisha nën sqetull dorëshkrimin e përmbledhjes sime me tregime "Dënesje", por brenda vetvetes bartja lumturinë që do njoftohesha me prozatorin që aq shumë e doja. Ishte fjalë pak, bartte në vete një qetësia të mahnitshme. Dhe përderisa i ndrojtur ia dorëzova dorëshkrimin, pyesja vetveten si ishte e mundur që ai njeri aq fjalëkursyer dhe i qetë, t'i kishte shkruar ato tregime, drama dhe romanin "Oh". Asokohe duhej të kalonin vite, e jo muaj, që të botoje libër. Por për çudi, nuk kishin kaluar as tre muaj nga dorëzimi i dorëshkrimit, kur Pashku më telefonoi që të shkoja të takoheshim. Dhe shkove në zyrën e tij, i parapërgatitur se do më këshillonte t'i përpunoja tregimet, në stilin 'këtë mund ta bësh roman', e tjetrin mund ta shkurtosh. Por nuk ndodhi asgjë nga ajo që unë paragjykoja. Më shikonte i heshtur, që më në fund të më tregonte se libri im do botohej dhe se isha tregimtar i mirë. Unë mezi që përmbahesha nga gëzimi i papritur që më pushtoi. Posaçërisht asokohe kur posa i isha kthyer të shkruarit shqip.

Dhe para se të ndaheshim, ai doli të më përcillte deri te ashensori. Si për drej, ashensori vonohej e vonohej, gjë që më bënte të ndjehesha keq, e që më çoi ta lusja të kthehej në zyrë e të mos humbiste kohë duke pritur me mua. Dhe atëherë ai tha fjalët që asokohe, a edhe gjithmonë pastaj, do kishin madhështinë e 'çmimit' që për veprimtarin letrar merret vetëm njëherë në jetë dhe që asnjë tjetër nuk do mund ta tejkalonte - "Unë

ty të kam pritur njëzet vite me radhë!" Gjatë tërë rrugës prej Prishtine deri në Shkup, dëgjoja jehonën e fjalëve të tij. Fjalë që më çuan t'ia pranoja vetes se ish bërë shkrimtar! Në të vërtetë, që nga ajo ditë, unë fillova t'i përkushtohem krijimtarisë letrare, duke u kujdesur të mos e tradhetoja besimin e atij që për mua, ishte dhe mbeti maja e tregimit shqiptar. Që nga ai takim me Anton Pashkun, e gjer më sot, kanë kaluar shumë vite. Siç kaluan edhe vitet kur merresha me shitjen e librave dhe kur një nga blerësit, i përballur me kompletin prej dhjetëra libra të një autori, tha: Si u shkruakan një metër libra!? Dhe që atëherë, sa herë që dëgjoj të flitet për botimin e vrarave të plota të ndonjë autori, më rikujtohen këto fjalë të largëta nga e kaluara, e që më çojnë të ndjej refuzim ndaj kompleteve prej 'një metër libra'.

Gjithashtu, kur dëgjoj të flitet për botimin e kompletit të veprave letrare të ndonjë autori, sërish më rikujtohet Anton Pashku dhe viti 1986, kur Sh.B. 'Rilindja' kishte botuar kompletin e veprave të tij letrare. Komplet të cilin ai ma dhuroi, e që edhe sot e kësaj dite, është më i çmuari në bibliotekën time. Komplet që përbëhet nga tre vëllime: ai me drama, me tregimet dhe romani 'Oh'. **-Çfarë është më e frikshme, tani kur shihni jetën dhe shkrimtarin, sy ndër sy?**

K. Mehmeti: Asgjë nuk është e frikshme, por shumëçka është tronditëse. Në të vërtetë, vjen një ditë kur njeriut i duket vetvetja si i ngjitur në majën, nga shikon udhën që ka ecur. Dhe shpesh i dhimbset vetvetja për ecejaket e kota dhe për ato që i kanë shkaktuar lodhje e dhembje, apo për ato që kanë qenë të mundimshme. Edhe rrugëtimi im jetësor është përplot me kthesa, me ngjitje zbritje tronditëse e të lodhshme. Por kryesisht kam jetuar ngutshëm dhe kam pasur jetë të mbushur përplot me përmbajtje dhe lëngje të ndryshme. Kam jetuar dhe krijuar i bindur se jetëgjatësia nuk matet me vite, por nëpërmjet përmbajtjes që ajo ka në vetvete. Siç i kam mbetur besnik edhe bindjes se ne nuk jemi as atë që të tjerët thonë për ne, as atë që mendojmë për vetveten, por ai që e thonë për ne veprat dhe gjurmët që shënojnë rrugëtimin tonë jetësorë. Dhe kur unë i sotmi përballem me atë që ka qenë atje dhe dikur, ndjehem mirë dhe ngushëllohem se mbase nuk kam bërë asgjë për t'u mburrur, por jo edhe diçka për t'u turpëruar. E ngandonjëherë kjo mjafton që të jetosh në paqe me vetveten.

-Marrëveshja për këtë intervistë është letërsia. Por, jeni ndër zërat e pakët që ka dëshmuar se si intelektual, shkrimtari dhe ekzistenca juaj edhe si

(Vijon në fq. 6)

Edhe sot, më ndodh të ndjehem keq kur e shoh se nëpër 'Shqipëritë' tona, më lirshëm qarkullon droga, se sa libri i botuar nëpër qendrat shqiptare. Por tani jo pse këtë na e ndalon dikush, por pse jetojmë në shtete ku është thuajse a pamundur ta kuptosh se vallë burrështetasit tanë e kontrollojnë krimin, apo kriminelët i kontrollojnë shtetet. Dhe pse ka filluar të na pëlqejë të jetojmë të ndarë nëpër principatat tona politike, letrare e kulturore. Kemi filluar pra të ndjehemi të vetëmjaftueshëm e të vetëkënaqur nëpër 'mëhallat' tona krijuese e kulturore.

(Vijon nga fq. 5)

njeri politik ju ka shënjuar si autoritet i mendimit. Cili është Ballkani juaj, shqiptari juaj, familja...në çfarë keni besuar?

K.Mehmeti: Gjithmonë e kam pas të qartë se botën nuk mund ta ndryshosh duke shkruar poezi e romane, e as duke i kritikuar të tjerët, por kam besuar dhe besoj se ia vlen të bësh çmos që mos të të rrëmbej turma e të zhdukesh në të si i pazëshëm dhe i pafytyrë. Pastaj kam jetuar me bindje se për një njeri publik, është e pafalshme të mos e thotë atë që mendon dhe atë që do donin ta thoshin ata të cilëve askush nuk ua ofron mikrofonin dhe askush nuk i pyet se çka mendojnë lidhur me vetveten e të tjerët. Kam dashur të bëjë atë që më bie në hise si shkrimtar dhe si njeriu që pa ia kërkuar dikush, ka filluar të merret edhe me shkrime e paraqitje publicitare. Dhe këtë e kam ndje si borxh ndaj vetvetes, e jo ndaj të tjerëve. Në të vërtetë kështu e shpërlaja borxhin që shkrimtari në mua ia kishte qytetarit në mua, familjes së vet dhe popullit. Jo se nuk e kam ditur që më lehtë jetohej kur e mbështet të pushtetshmin, e të fortin, por doja të jem me të pambrojturin dhe të papushtetshmin, ngaqë ashtu ndjehesha më mire dhe më i fortë. E bëra këtë zgjedhje pse besoja se kështu do ia dal të mos turpërohem nga fytyra që ia kem zgjedhur vetvetes. Pastaj doja të dëshmoj se ia vlen të mbrosh parimet në të cilat beson dhe se jeta është e shkurtë që të mos mund t’u përmbahesh vlerave njerëzore që ua rekomandon të tjerëve. Shpresoj se ia kam dale të dëshmojë se jam marrë me politik jo që të përfitoj nga ajo, por që të dëgjohet edhe zëri i humbësve.

Pra shpresoj se ia kam dalë të dëshmoj se kam qenë kritik ndaj dukurive negative nëpër shoqëritë shqiptare jo pse më dallon ndonjë guxim i veçantë, pop pse jam ‘frikacak’ i pashoq – pse kam pasur frik nga dita kur fëmijët do më pyesin se ç’bëre ti që e sotmja jonë të ishte më e mirë? Sado që dikush mund të mos e besojë, por do e them: zërit tim politik më ka dëmtuar e nuk më ka sjell asnjë të mire. Dhe jo vetëm mua, por edhe të afërmve të mi, zëri im politik na ka sjellë vetëm shqetësime. Por megjithatë, ai zë më ka mundësuar të jetojë në paqe me vetveten dhe të jem i atillë siç më pëlqente vetvetja.

-Vlerësimi në panairin e Tiranës është për rrëfimin poetik, që nis nga vetvetja, pothuaj një udhëtim, që merr dhe jetët e njerëzve me vete, i nxjerr nga e kaluara, i tregon, një lloj gjenaologjie familjare që zbërthen një fshat, një atdhe, një etnitet. Pse e gjithë kjo në një fjalë të vetme, me metaforën “Pusi”?

K. Mehmeti: Gjatë jetës së vet, njeriu vetëm e thellon pusin e kujtimeve dhe i shkurton shkallët e shpresave. Që më në fund, në vitet e pleqërisë, kur e nesërmja është thujse pa të nesërme, pra kur shkurtohen shkallët e ëndërritjeve dhe të shpresave dhe kur pusi i kujtimeve thellohet deri në ditëvdekje, mbeten vetëm kujtesa për të shkuarën. Ku ta dish, mbase ne edhe nuk jemi asgjë më shumë se kujtim i së kaluarës dhe ëndërrimtarë të se ardhmes. Dhe ndoshta jemi vetëm vazhdim i ëndrrës së atyre që e kanë ëndërruar lumturinë tonë. Dhe prandaj, sa më shumë plakemi, aq më shumë e ndjejmë mungesën e atyre që na kanë rritur e dashur.

-Shumë elementë, histori, ngjarje dalin aq autentike, të jetuara, reale saqë lind pyetja, si mund ta trajtojmë këtë roman si një rrëfim i Kimit, apo një roman autobiografik?

Kadisamomente në këtë roman që lidhin historitë familjare, mjediset, kujtimet, nënën dy romanet e fundit, duken si të përsëritura...pse ky tërhiqeni nga ky fill drejt të kaluarës, kujtesës?

K. Mehmeti: Sado që tingëllon e pabesueshme, në librat e mi ka shumë pak elemente autobiografike. Më shumë kam shkruar për të munguarat se sa për ato që i kam pasur. Për shembull, unë kam shkruar shumë për gjyshet e ‘mia’ edhe pse gjyshja nga ana e nënës ka vdekur para se nëna ime të martohej, ndërkaq ajo e babait ka vdekur në moshën time pesëvjeçare. Por megjithatë, edhe duke shkruar për atë që më mungonte, unë kam rrëfyer për të përbashkëtën e familjeve të këtushme shqiptare. Në ndërkohë duke i mbetur besnik bindjes se është e vështirë të bësh artë nga jetëpërshkrimi yt. Siç besoj se çdokund në veprat e tij është autori edhe atë në mos më shumë atëherë nëpërmjet bindjeve të veta.

-Sigurisht, nuk mendojmë se me çmimin e karrierës ju përmbyllni epokën tuaj krijuese. A keni dorëshkrime, apo ide të projektuar për më tej?

K. Mehmeti: E thash edhe më lartë: nuk kam qen e nuk jam krijues që çdo gjë ia përkushton krijimtarisë. Pastaj nuk jam njeri i koncepteve dhe projekteve të parashikuara jetësore. Prej moti e kam kuptuar se duhet të jetosh me bindjen se dita e ardhme do i përmbush të gjitha ëndrrat dhe dëshirat tua, por duke qenë i gatshëm të jetosh me atë që do e sjellë e nesërmja. Andaj kurrë nuk jam lodhur me atë se si do duket fundi im jetësor e krijues. Nuk jam as krijues i cili çdo ditë shkruan diçka. Përkundrazi, ka periudha kohore kur as që e njoh krijuesin në mua. Por kjo fare nuk më brengos. Nuk kam pasur ide të projektuara parapraket as për librat që i kam shkruar, as kam për ato që ndoshta do i shkruaj. Shkurt e shqip: epoka ime krijuese do varet nga ajo jetësore. Por edhe nëse çdo gjë do përfundonte me kaq, nuk do ndjehesha keq. Pastaj më shumë se e nesërmja, më intereson ajo që kam arritur deri më sot.

Shoqata e Botuesve ndan çmimin për krijimtarinë origjinale më të mirë të vitit për autorin Brajan Sukaj me romanin “Ciklopi”, botimet “OMBRA GVG”, me motivacionin: “Për ndjeshmërinë e thellë njerëzore përmes një ligjërimi sa real aq edhe fantastik”.

Brajan Sukaj

Mundohem të pikturoj me fjalë atë që përfytyroj

-Me romanin e parë, në panairin e librit u vlerësuar me çmimin “Libri më i mirë i vitit”. Si e ndjeni veten?

Këtë vit kapatur një prurje të konsiderueshme botimesh, diku tek njëqind e tridhjetë, ku, gjysma përbëhej nga autorë të huaj dhe gjysma tjetër nga autorë shqiptarë. Duke marrë parasysh shifra të tilla, ndjehem mjaft i kënaqur që juria midis tyre zgjodhi dhe vlerësoi punën time.

-Ju jeni i ri dhe ndoshta të rinjte duhet të jenë lexuesit tuaj. A mendoni se Ciklopi është një roman edhe për rininë?

Mendoj që romani është për të gjithë grupmoshat, sepse, duke qenë se ka një strukturë të thjeshtë dhe konkrete, është lehtësisht e kapshme për çdo lexues.

-Që në faqet e para të librit, diku midis ngjyrave dhe fjalëve, nderton ngjarje të çuditshme sa fantastike aq dhe njerëzore. Shoqëria gjithmone ka patur problem me humanizmin dhe shpesh artistet kanë synuar të ndërtojnë lidhjen e individit me llojin dhe ju mendoj se e kërkon këtë gjë me anë të një procesi vetërregullimi shpirtëror. A mendoni vertetë kështu?

Lidhja e individit me llojin në këtë libër shpjegohet nëpërmjet mitit. Njeriu që në fillimet e tij mundohet t’i përgjigjet pyetjes “Përse gjërat janë në këtë formë, dhe jo në një trajtë tjetër?” Dhe përgjigjet vijnë ose nëpërmjet shkencës, ose nëpërmjet fesë, ose nëpërmjet filozofisë ose nëpërmjet mitit. Por vepra ndalet tek kjo e fundit. Miti është një besim që nuk ka më ndjekës, pra një besim që ka ngelur në histori. Dhe, duke qenë se ka ngelur në të shkuarën, natyrisht, mënyra se si serviret në kohët tona, janë rezultat i këndvështrimeve të njerëzve. Ciklopët në mënyrën se si serviren në tekste, ose në përfytyrimet e shoqërisë, shihen si krijesa të tmerrshme dhe të frikshme, dhe libri merr përsipër të shpjegojë, përse ka ndodhur kjo gjë? A është këndvështrimi i shoqërisë në një situatë reale, zanafilla e miteve?


-Po citoj një frazë nga libri: “Në një rast të

tillë kufiri midis mrekullisë dhe mallkimit është aq i hollë, sa nuk mund të dish se ku mbaron i pari dhe ku fillon i dyti”. Vërtetë mendoni se populli ynë e ka ndertuar jetën në këtë mënyrë?

Fjala mallkim ndoshta do të ishte anatemuese për vendin tonë por është një fakt që populli ynë ka qenë vazhdimisht nën zgjedhën e një pushtuesi apo të një tjetri dhe në libër trajtohet kjo gjë. Në tekst nuk përcaktohet qartësisht pushtuesi, kjo është bërë jo pa qëllim, sepse, duke qenë një popull i cili ka vuajtur peshën e njerit okupator ose tjetrit, kjo i lihet imagjinatës së lexuesit ta vendosi veprën si në periudhën romake, bizantine, otomane, apo edhe fashiste, rezultati, mendoj, nuk do të ndryshonte. Në libër merret edhe shembulli i fesë, ku kemi një devijim nga klisheja e zakonshme që pushtuesit e kanë kthyer me dhunë fenë e vendit.

-Në përshkrimet që i bën qytetit, e sjell atë ashtu siç ka qenë, te duket sikur shikon pamje të nxjerra nga historia, sigurisht të zhdukura sot, por e ndjen se të mirat dhe të keqijat nuk i kanë marrë me vete. A e keni fjalën për një qytet të caktuar?

Kur kam nisur të shkruaj librin, kisha nevojë për një imazh të qartë të qytetit ku do të zhvilloheshin ngjarjet. Qytetin në fjalë e kam vizituar dy herë. Një herë para se të shkruaja librin, dhe një herë pasi e kisha përfunduar veprën. Është interesant fakti se, kur e vizitova për herë të parë, pasi kaloi pak kohë, e harrova se si ai ishte dhe u detyrova të rindërtoja çdo gjë me imagjinatë. Kur e vizitova për së dyti, pra, pasi përfundova punën, vura re që qyteti ishte pikërisht ashtu siç e kisha përshkruar në libër, vendosja e maleve, bimësia, gurra, shtëpitë dhe godinat e kultit. Këtu nxorra përfundimin se si formësohen gjërat në nëndijen e individit. Gjithësesi ai mund të jetë një qytet çfarëdo. Historia bën fjalë për një grua me fëmijën e saj në një qytet pak të përcaktuar, është një histori e thjeshtë por



kushdo mund të nxjerri përfundime të ndryshme në varësi të shijeve apo këndvështrimeve.

-Dikush e ka quajtur librin tënd një galeri pikturash ku degjohet ai që flet për to dhe ato ndërtohen në përfytyrimin e lexuesit. Cila do të jetë piktura e re në letërsinë tënde?

Letërsia është para së gjithash një art, dhe në këtë pikë ka shumë pika të përbashkëta me pikturën. Në të parën gjërat përcillen me fjalë, në të dytën me ngjyra, por, duke qenë se letërsia disponon edhe figurat letrare, ironinë, mbivendosjen, kjo gjë e bën letërsinë me efikase se piktura në përcimin e ndjesive, gjendjes emocionale dhe botës së brendshme të personazheve në vepër. Përshkrimi i natyrës, i motit dhe i qytetit, i cili bëhet vazhdimisht në vepër, sillet me qëllim që të përshkruajë paralelizmin e tyre me botën e brendshme të personazheve dhe, pse jo, edhe të rrëfyesit i cili, nuk duhet harruar se është një entitet i pavarur nga autori.

Mundohem të pikturoj me fjalë ate që përfytyroj në

Përvojat e një paraardhësi të një shkalle të katërt, ruhen në gene, dhe transmetohen brez pas brezi në ate që, në psikologji quhet e nënvetëdijsmja dhe shumë gjëra, duke përfshirë dhe ëndrrat vijnë nga kjo masë e madhe e nëndheshme. Nuk jam i sigurtë për vërtetësinë e diçkaje të tillë, por mund të them që veprimtaria krijuese është diçka shumë e vështirë që të shpjegohet me fjalë.

mënyrë që të bëj sa më konkrete ate që dua të shpreh.

-Përse shkruani për tema të tilla? A nuk ka diçka tjetër që do t'ju shqetësonte së brendshmi, diçka më personale?

Siç e kam pohuar dhe më parë, është e vështirë për një autor të thotë arsyen se përse një vepër është në ate formë, apo trajton atë temë. Mendoj që vepra ka ekzistuar gjithmonë në nëndijen e autorit dhe, kur çasti vjen, ajo del vetë, është diçka e vështirë të shpjegohet me arsye. Disa teoricienë të psikologjisë shtyhen aq larg sa shprehen edhe për përvojat e trashëguara. Pra përvojat e një paraardhësi të një shkalle të katërt, ruhen në gene, dhe transmetohen brez pas brezi në ate që, në psikologji quhet e nënvetëdijsmja dhe shumë gjëra, duke përfshirë dhe ëndrrat vijnë nga kjo masë e madhe e nëndheshme. Nuk jam i sigurtë për vërtetësinë e diçkaje të tillë, por mund të them që veprimtaria krijuese është diçka shumë e vështirë që të shpjegohet me fjalë.

ÇMIMET E PANAIRIT TË LIBRIT 2018


Panairi i Librit 2018 ka vlerësuar dhe këtë vit veprat më të rëndësime që u prezantuan para publikut. Shkrimtari Kim Mehmet është vlerësuar me çmimin e madh të Karrierës në edicionin e 21 të Panarit të Librit. Shkrimtari është vlerësuar me romanin "Pusi" nga Mapoedition me motivacionin "Për stilin origjinal në krijimin e polifonisë artistike që karakterizon romanin "Pusi" si dhe gjithë veprat e tij letrare". Më herët Mehmeti pati gjatë këtij panairi dhe promovimin e kolanës së plotë të veprës së tij nga Logos A.

Çmimi për krijimtarinë origjinale më të mirë të vitit shkoi për autorin Brajan Sukaj për romanin "Ciklopi" me motivacionin: "Për ndjeshmërinë e thellë njerëzore përmes një ligjërimi sa real aq edhe fantastik". Çmimi për përkthimin më të mirë shkoi për Donika Omarin për përkthimin e romanit "Nga ana e princeshës së vdekur" të autores Kenize Mourand me motivacionin "Për shqipërimin dhe gërshetimin mjeshtëror të identitetit gjuhësor e artistik".

Çmimi inkurajues iu dha dy krijuesve të rinj Iva Nikolli me romanin "Vetëm për ty" dhe Flogerta Krypi me romanin "Gjithçka rreth asgjësë". Poeti Zef Skiro Di Maxho u vlerësua me çmimin special për "Poema Arbëreshe". Kurse çmimin për shqipërimin më të mirë nga gjuha franceze i shkoi Ilia Lëngun, për përkthimin e veprës "Të drejtët" nga Albert Camy.

AKADEMIA KULT NDAU ÇMIMET E 2018 "ATI" I ARDIAN KYÇYKUT LIBRI MË I MIRË I VITIT

Në një mbrëmje gala, Akademia Kult ka shpallur romanin e Ardian Kyçykut si libri artistik më i mirë, i viti 2018. Romani "ATI", publikuar nga "Botimet Poeteka", vjen si një himn kushtuar prindërve, flijimeve të tyre të pafundme dhe heshtjes së përkorë i që shoqëroi, përkushtimit që jo gjithmonë u shndërrua në mirenjohje dhe keqkuptimeve të shumta me shoqërinë dhe kohën në të cilën jetojmë.



Epokat dhe popujt zakonisht nuk bëjnë gabime në vlerësimin e artit të madh. Edhe kur gabimet ndodhin, nuk janë veçse të përkohshme. Gjithmonë vjen ora kur të vonuarit mbërrijnë dhe të munguarit shfaqen. Kështu kanë për të zënë vendet e tyre Anton Pashku i Kosovës dhe Zef Zorba i heshtur, dhe të tjerë ndoshta, të cilët, prej rastit ose rrethanave, janë penguar diku.

Tiranitë, krahas nervozizmit dhe stuhive kalimtare, janë përpjekur të krijojnë portat e rreme e të gabuara.

Në ngrehinën e përkorë të letrave shqipe, atje ku është duke zënë vendin e vet Martin Camaj, ashtu si

KADARE PËR
MARTIN CAMAJN

në çdo panteon, hyhet vetëm prej një porte, asaj të madhes. E ajo portë, siç e tregon emri, nuk njih veçse arsyet e mëdha.

Siç është thënë dikur, De Rada i paharrueshëm, në një përshkrim të natës së pashkëve, ka rrëfyer për “engjëjt që e bëjnë veç gostinë e tyre”. Në tryezën e epërme, ku kanë zënë vend krenajat e letërsisë, nuk ngjiten zhurmat e vogla e as afrohen profilet e rëndonmta. Atje ka përherë mirëkuptim e harmoni, ndaj e kremtja vazhdon përherë dhe ndriçimi i shandanëve nuk sos.

(Pjesë nga parathënia e Kadaresë botuar në vëllimin e parë të veprës së plotë të Martin Camaj)

PASTORALE

Se ndiesha veten ogiç
po fëmijë i vonuem pa gojë
i cili mbasi iu rritën brinat
blegroi për së pari
me za kingji – tëmerrueshëm!

E fyelli im binte thartë
në zyft e gjak udhëve
të qytetit:

ishte Prandim i një dite
e binte rig shiu vjeshtor
mbi kripin tonë thijash
çeliku.

POEZI
nga
MARTIN
CAMAJ



KTHIMI

Varrët janë mbyllë përjashta.
Faleminderës, o shikim i diellit,
që priresh edhe sot mbi trupna tonë.

Pse jam shqiptár,
trishtimi i kaluem i seme amë
jeton si gjaku i sáj në mue:
të gjitha hapsitë avyten në gjansinë
e dritës së syve.

Edhe rêtë janë ulë e i prekim me dorë.

Kur tallazi të bijë në pushim
e njimij bimë ujce kryepezull
të përshëndesin ngjyrat e agut,
due me kthye në jetë buzë ujit
që e njoh si vehten.

VENDITTIM

Kur të vdes le të bâhem bâr
në malet e mija në pranverë,
në vjeshtë do të bâhem farë.

Kur të vdes le të bâhem ujë
e fryma e eme ávull,
në fusha do të bie si shí.

Kur të vdes le të bâhem gúr
në skâjin e vendit tem
të qindroj kufí.



TË SHUMTË 1961

Vdekja mâ i thjeshti mendim.
Ndër vorre e prunë gurin e shkoqun
prej malit dhe e bâne mbret.

Vdekja mâ i ngulmi mendim.

(Që, për shëmbull: treni i sáj mbrin.
E më përshëndet me dorë, ajò.
Në gisht i shoh unazën e besës
së lidhun me mue në lemje.)

Vdekja mâ i kullueti mendim.

Nuk hypet maje gurit të shkoqun prej malit,
po atij që e puth i çelet ndër sý
nji detë i bardhë.

Vdekja mâ i thjeshti mendim.

DËSHTIMI


Nuk e çova zanin në kor
aty ku duhej: prej frike, turpi?
“Atëherë, del jashtë! – Më tha mjeshtri.
– Del jashtë!”

Prej të mbramit rresht në fund
u shkëputa, spec prej vargut në tra,
e njeha shkallët një nga një
deri në fund,
nën dhë
me peshën e njiqind syve në krahë.

PESHA

Pesha e skamnisë
po më ndrydh, Hera.
Pranë meje lumej grunoresh
e unë jam i unshëm.

E jam sytrishtë, Hera,
kur shoh mes grunoreve
ty, tue ecë si frymë
me bukë në krah.



KISHTE ARDHË PËR MIK

Kishte ardhë për mik një njeri i hajshëm
e i zbetë si letra.
Thoshin se ai me dorë të vet kishte vrá
tre vetë e tash ásht pendue.
E më kujtohet si djë
qeleshja e tij e bardhë,
një sumbull e kuqe në kraholin e zí
e sjellja e përvujtë e ndeja e tij në shkam
pranë votre para një tryeze të vogël:
një të katërt bukë misri e 'i grusht krypë
kishte përpara – si mbas dëshirës së tij.
“Gjinoj e mbaj çdo ditë – tha ai –
pse fajet e mija janë tri thika
sa tri maje malesh kërcnuese
kah qiella e Zotit!”
Kojet e bukës krisshin nën dhambët e njeriut
që përtypte trishtueshëm, njerzishëm
e me shije

VESHJA ARBRESHE

Ku janë vektaret duer-holla?
Andruen dasma e kënduen me za të lezëm
ndër plangje guri e bardhë
përmbrenda. E tash

ngrihet në pikturë zemra e nuses
para petkut të grisun:
e grisi ganjuni dorëzi e krye-çot
natën e karnevalit
tue ardhë rro-rro deri në dritë.

Erdhi stërnipja e urtë e veshi
petkat e gjyshes. Erdhi nga larg
e luejti vallen e lashtë te sheshi.

N'ora dhetë veshja arbreshe
u zhgreh e ra para kambëve ma t'bukura
se t'gjyshes nuse në pikturë
e kthyen ndër arka keza e coha
palë e palë,
linja erë-mirë
e ngime me gjij ma vashëz.

GJARPNI E GRUEJA

Ajo mbramë harroi trupin e vet
zbuluet
e në mëngjes e gjeti pikturë të varun
në murin e gjanë dhetë pashë:
e kqyri dhe e kqyri e u zhduk.

Petkat e saj teren buzë detit
me këmishën e gjarpnit mbi gurë.
Shtërpia tha se vjen prap, ajo,
deri mbasdite.

Mbasdite vonë, gjarpni i rrejtun
doli prej nëngurit
e iu zgërdhesh vetmisë ndërsy,
veshi këmishën e vjetër e shkoi
me fjetë.

MBAS VDEKJES SË POETIT

Ti qe frymshkurtë
pse guri në mal s'e ndieu
peshën e vargjeve tua.
Emnin tand e harruene vashat
dhe hija e vargjeve tua
vrân vetëm sytë e grave
të pjekuna, andërrtare
të rinisë së kalueme
e të thjeshtë.
Shokët e tu, poetën, thonë
se ti more me vete, sall ngjyrat
e sendeve në sy
as me pasë dashtë me ikë e shkue
pa emën.

MARTIN CAMAJ
PËR VETEN DHE
POEZINË E TIJ

*Krijimi i poezisë në liri ka tjetër cilësi
përjetimi, shujta, ushqimi tjetër shije dhe gjumi
tjetër qetësi e prehje. Në të ardhmen do të kthejë
në vend edhe ai druni i Ndrë Mjedës, nxjerrë nga
malet e fushat shqiptare, me të cilin u ndërtuen
anijet që sollën gjithë atë mori shqiptarësh
andej deteve (shih Ndre Mjeda: I të buemi nga
“Juvenilia”). Me atë dru mund të ndreqen sende
të tjera.*

*Në këtë situatë u gjetën edhe autorët
shqiptarë që kërkuen lirinë jashtë, në mënyrë
anticipuese. Ne u kapëm për mbamendjen
historike të kombit, si i mbytuni për shkumë. S'do
qitë mendësh se afër një e tretë e njerëzimit sot
janë të ikun a të shpërngulun nga vendlindja. Si
përvojë gjindeshin në një shoqni të stërmadhe.
Po të flasim për poetin dhe situatat e tij!*

*Poezia si formë lidhet për gjuhë. Poeti
mërgimtar që me të vërtetë don me mbetë ashtu
si ashtë, merr frymë përmes gjuhës amtare dhe
sheh dita ditës si fjalët e saj shyten në nënvetëdije
e harrohen. Gjysma e jetës kalon në kërkimin
e fjalës së vet të humbun. Ai bie në një vorbull
e sillet rrethas dhe del kur kujtohet se bashkë
me të, me poetin, ka mërgue edhe fjala (ky
skajim “l'esilio della parola” u trillue nga disa
antropologë italianë që merren me kulturë e
gjuhë arbëreshe).*

*Zhdërvillimi i fjalës përnjësohet me proceset
e krijimit artistik që mund ta përfytyrojmë si një
fryt, pjeshkë, thelbi i së cilës ashtë qenia njerëzore
si shqiptar, për shembull. Fjala e tij me kuptime
specifike përpiqet me gjuhë të ndryshme dhe
mundet me iu zgjanue edhe kuptimi, natyrisht,
pa u zvetnue.*

*Me këto ide të qarta në krye nis e gdhend
vargun nga, me kohë e përvojë, shpërthejnë
tinguj të rij dhe struktura tekstesh në trajtë të
vet të përsosuna. Kësaj udhe shkuen De Rada
dhe Schirò që me poezinë e tyne zbuluen thelbin
e një miti të ri që përmban fatin tragjik dhe
vullnetin me mbetë gjallë si vetje e fis, marrë si
tanësi arbëri i arbreshit Nikollë Ketës.*

*Kuptimi i një lirike të tillë s'ka si të
përnjësohet deshtas me nacionalizmin modern
apo me ideologjitë moderne dhe as me filozofinë.
Ajo në vetvete ashtë e shpjegueshme sepse ajo
lirikë mbështetet në përvojën e mitit të lashtë,
përçue nga struktura komunikative natyrore si
janë besimet popullore e fenat.*

*Ky lirezëm për shumë poetë mërgimtarë të
letërsive të vogla, si e jona, vjen vonë, në moshë
të shtyme. Ata edhe kur janë të grishun në ndoj
festë popullore ose në ndoj darkë mbërrijnë
vonë, gjithkund tepër vonë! Arsyeja ashtë se ata
tanë jetën me torbë në krah prej vendi në vend,
humbën edhe ndijimin e kohës, mosdallimin e të
sotmes me të nesërmen.*

MARTIN CAMAJ
Mynih, maj 1991

Shkrimtari Agron Tufa riboton romanin “Fabula rasa” – që prej vitit 2004 romani vazhdon me të njëjtën jehonë, e ndjeshmëri përballë lexuesit duke rikthyer vemendjen tek individ, dualiteti i tij, me shqetësimet morale e shpirtërore. Eseja e mëposhtme risjell këtë vëmendje

FABULA RASA

NJË ROMAN PIKARESK

DUALITETESH

Hiperrealiteti që shpërfill dhe anashkalon dallimin midis vdekjes e jetës dhe metarrëfimi i së kaluarës që ka rënë



Nga ARIAN LEKA

Ka vepra letrare që nisin dhe kryhen si ngjizje krejtësisht e re gjuhësore e narrative (*lëndë+stil+zhanër*), duke ruajtur prej autorit vetëm shenjën e tij letrare dhe çka është e patjetërsueshme prej tij. Por ka gjithashtu edhe vepra të tjera që, me parapëlqimin e autorit, vijnë si binjakë dizigotikë - krijesa të së njëjtës mitër, të cilët edhe pse nuk ngjajnë, duket se janë ushqyer nga i njëjti kordon.

Romani i Agron Tufës, “*Fabula rasa*”, duket se e ka dhe e shpall një paraardhës stilistikor - për fat vetveten - romanin “*Dueli*”. Veçse lidhje mes tyre nuk është vetëm “dueli real dhe metaforik vihet në kërkim të vetvetes drejt shpalimit të shtresimeve të identitetit moral, psikologjik, drejt profilin shpirtëror”, siç është theksuar. Atyre i bashkohet edhe rimarrja e thelbit më shprehës dhe ekzistencial të njeriut që baret nga Erosi drejt Thanatosit, nga paqenia drejt hiçit.

Me gjithë ngarkesën e viryeteve dhe të veseve njerëzore, që nga besnikëria burleske ndaj karakterit të lindur të personazheve e gjer tek përshtatja e po këtij karakteri, përthyeshmëria, mbijetesa thujse instiktive dhe dhunimi i dashurisë metafizike, karakteret e këtij romani sjellin implikime të rëndësishme, të cilat edhe pse preken që në hyrje të veprës, i zbulojnë vlerat vonë.

Megjithatë, ndonëse e njeh si paraardhës, duket shtuar se “*Fabula rasa*” nuk ndjek gjurmët dhe as bëhet vijim i romanit “*Dueli*”, duke shembur kështu çdo hamëndësim për vepër ciklike. Por një projekt apo një koncept duket

se ekziston, madje duket se një formë triptiku pritet ta mbyllë ciklin e parë romanor të këtij autori me profile të qarta e të shfaqura.

Për ata që duan ta shohin si të tillë, duke dashur t’i mëshojnë më shumë të përbashkëtave sesa veçantive, mund të theksohet se dy romanet e Agron Tufës kanë të ngjashëm atë që e bën të ngjashëm një urë me gjithë urat.

Po kështu, titulli i romanit të parë është mbartur si sfidë edhe për duelin e ri të autorit me lexuesin e “*Fabula rasës*”. Por në nivelin konceptual, zbrazëtira e *tabula rasa*-s, kjo pikë zero e nivelit narrativ, bëhet e domosdoshme për autorin që kërkon të shfaqë e lëndën e re. Hapësira e zbrazur e narrativës vihet e gjitha përballë *fabula rasa*-s, prej nga që zë fill metarrëfimi i së kaluarës që ka rënë dhe prej ku subjekti nuk mundet ta kontrollojë dhe as ta kuptojë më deri në fund objektin, siç do e përkufizonte Lyotard.

Do të ishte pretendim i pakët të pohojmë se ajo që Agron Tufa shfaq përmes këtij romani qenkësht thjesht një çështje teknikash rrëfimtare apo raporte autoriale me kulturat, civilizimet dhe teknikat letrare të shkrimit.

Fabula rasa është kujtesë e përdorur si rrëfim dhe vetërrëfim. Është jeta me shqisat drejt realitetit të veshur me gjuhë e kuptimësi mbitekstuale. Është hiperrealiti vetë, si gjendje gjuhësore, emocionale dhe sociale, që përpigjet (gati me lutje) të vendosë lidhje kuptimësie me këdo, duke përdorur gjithë sa është e mundur, gjithë mjetet narrative që zotëron. Dëshirat e përmbushura (realiteti) dhe fantazitë bëhen bashkë për një histori vetiake pjesëtuar ndër të gjithë nga pak. Ky fat dhe gjurma që ai fat ka lënë mbi ne, apo më mirë mbi ata që reagojnë estetikisht, emocionalisht e moralisht mbi këtë copëz historie, sjellë si vepër arti.

Në këtë kuptim “*Fabula rasa*” shfaqet si një ndjesi e jetuar rishtas, si një roman me disa elemente pikareskë (referuar teknikave letrare apo modelit sesa të këtij zhanri shekullor të romanit) në shtjellimin e asaj që ndodh, sidomos të antiheroit, kryer përmes teknikave të begata rrëfimtare vendosur në hiper/realitetin që shpërfill dhe anashkalon dallimin midis vdekjes dhe jetës, nëse do zgjidhnim fjalët e Baudrillard lidhur me parimet e pasigurisë brenda ekzistencës

shoqërore, të cilat mund t’i përdorim si çelësi i analizës tekstuale.

Ajo që është ngulmuese në roman dhe që lexuesi mund ta pikasë që në krye, është dualiteti i realiteteve dhe përjetimeve vetiake. Është “realiteti që ndodh” për të qenë thjesht një ngjarje e pazhbëshme në fatin njerëzor dhe i po ai realitet i përthyer në “realitet jehonë”, që tashmë përjetohet si një tjetër/realitet, më jetëgjatë, realitetit metaforik dhe i mbivendosur brenda së njëjtës ngjarje, brenda të njëjtit person.

Padyshim që autorit i është dashur jo një lojë zbrazur fjalësh për ta shndërruar “*tabula rasa*-n” e përgjishshme në “*fabula rasa*-n” tonë. Në këtë pikë është individ me karakter *wunderkindit* që hyn në veprim dhe i jep vështrimin retrospektiv veprës, teksa shtresëzon literalitetin e autorit me oralitin e artit demosiak.

Por mistika e fëmijës apo gjenialiteti i fëmijërisë dhe i rrëfimitarit fëmijë, që u tregon të rriturve historitë e tij, nuk është shpërdoruar me këtë rast. Përkundrazi. Frika shumëdimensionle, si element nxitës në rrëfim, ka bërë që *wunderkind*-i të vëzhgojë mirë njeriun në zvetënimin e tij jo thjesht vetiak, por edhe njeriun që është i mbërthyer pas trashëgimisë, si pjesë e psikologjisë kombëtare, të cilat jo gjithmonë janë vlera.

Mes kësaj vorbulle ngjarjesh e përjetimesh që ndodhin brenda dhe jashtë mendjes së tij, a duhet të rrijë në mes apo të mbajë njërën anë *wunderkind*-i? Ta braktisë atë trashëgimi (me vlerë e të përlyer) ngaqë ajo ka rënë apo ajo trashëgimi duhet rrëzuar me forcë ngaqë ishte primitive, kriminale, se nuk kishte më gjë për të dhënë dhe se ka mbërritur një rend i ri? *Wunderkind*-i dhe gjithë të tjerët që imlikohen në rrëfim nuk dinë të zgjedhin pozicionimin ndaj së Mirës dhe së Keqes, Bukurisë dhe Shëmtimit që po pllakos sërish.

Po t’i qasemi romanit sipas metodës formaliste apo neoformaliste, gjëja që do vërenim me një vështrim janë temat apo shtresëzimi vertikal i motiveve të mbivendosura. Teknika që Agron Tufa ka përdorur për mardhënien mes temave, si të ishin variacione që burojnë nga një motiv, është *Loja*. Loja me fabulën e hapur, përthyerja strukturore dhe përdorimi i shumë teknikave, stileve apo “guheve” narrative vë në lëvizje kureshtjen, duke zgjeruar sakaq edhe njohuritë.

AGRON TUFA

fabula rasa



OnufriRoman

Por brendashkruar romanit, si vlera të shpallura pa bujë, ndeshen gjithashtu edhe mikrostruktura tregimi, romani klasik rrëfimtari, eseja konceptuale e epilogut në perspektive, mjete prozodike dhe përdorime të efektshme metrike e gjer tek poezia e organizuar, të cilat ndihmojnë mekanizmin narrativ të funksionojë.

Tregimet brenda fabulës (të dalluara grafikisht nga nënkapitujt me shenjëza) si dhe romani i brendashkruar i Bitak Ballës, rrëfyer në gojëfoljen verilindore, që nuk shpreh vetëm gjuhë, por edhe mentalitet, etnos të ngallmuar brenda gjuhës, janë përthyerje strukturore të plota në të gjithë elementët kompozicionalë e rrëfimtari që i përngjet një vepre “të pambaruar” enkas.

Ajo që është e pranishme, e hapur, madje deri përndjekëse në roman, është etnosi i ndjeshëm brenda një botë shpirttrash, të kallur e të pakallur, që vinë rreth në kërkim të rimishërimit. Në kahje të kundër të prirjes efemere për modernitet të shtirur, të shitur lirë e të blerë lirë, autori ngulmon tek traditat, në kuptimin e asaj që i mbijetoi prishjes, qoftë edhe duke u strukur në thelbin e njeriut.

Narracioni në romanin “*Fabula rasa*” përjetohet gjatë leximit si një teknologji parashkrimore, duke sjellë në kujtesë kohëra kur autori dhe vepra ishin një dhe komunikoni pa ndërmjetësinë e shkrimit. Duket sikur vepra është shkruar sa prej autorit aq edhe prej karaktereve të tij, të cilët i bashkojnë gjuhës së autorit gjuhën e tyre prej jermesh, litanish, ëndrrat dhe makthet - një gjuhë në kufi të frazeologjizmit - e cila nuk lë vend as për mëdyshje e që nuk pranon të elaborohet e as të modifikohet gjenetikisht. Ajo gjuhë është një krijim stilistik i qëllimshëm, eksperimentale kur duhet dhe e funksionalizuar.

Kjo mënyrë rrëfimi, përfshi këtu proverbat, silabikët brenda fjalive, anonimatit poetik, si dhe poezitë e shkruara në metrikë dhe rimë, kanë krijuar edhe një rrafsh tjetër përfaqësimi më të gjerë të veprës, që nuk nënkupton vetëm komunikimin mes lexuesit dhe narratorit, por që dëshmon kalimin e suksesshëm të prozës në poemë zanafillore të aedëve dhe këndelljen auditive të leximit, jo me gisht por edhe me zë.

Tiranë, 2004

Një vështrim mbi ndërthurjen e zhanreve dhe poetikave në romanin shqiptar, si dhe konteksti kritik mbi romanet e shkrimtarit Mehmet Kraja

ANTIUTOPIA E MEHMET KRAJËS

Romani shqiptar, fillimi i shekullit XXI vetiu të ndërmend gjendjen e romanit shqiptar në fillim dhe përgjatë shekullit XX, shekullit paraardhës. Për të arritur në gjendjen e sotme të zhvillimit, ka kaluar në një proces të tërë të shfaqjes, formësimit, përdëgjimit të brendshëm në zhanre a nënloje të ndryshme. Para momentit të tanishëm, mendojmë, se janë dy momente të tjerë të rëndësishëm, që kanë përcaktuar zhvillimin e tij pa të cilët nuk mund të shpjegohen dukuritë, prurjet, tiparet, problemet dhe kahet bashkëkohore.

Momenti i parë është shfaqja e romanit në letërsinë shqipe, lëvrimi i tij në vitet 1913-1944. Numerikisht janë botuar 23 romane. Tipologjikisht u lëvruan disa lloje, kryesisht, romani romantik historik, sentimental, realist social dhe psikologjik më shpesh me përbërës heterogjenë. Me përjashtim të dy llojeve të fundit, që lëvroheshin edhe në letërsi të tjera europiane, llojet e tjera kanë qenë lëvruar një shekull e gjysmë dhe një shekull më parë.

Momenti i dytë është epërsia/hegjemonia e tij në letërsinë shqipe, në vitet 1970-1990, kur në një vit, në Tiranë, Prishtinë, disa herë dhe në Shkup, botoheshin, zakonisht, mbi 10 deri 21, 24 tituj. Më 1975 ka qenë pika më e lartë e kurbës së tij, përkatësisht 18 tituj në Tiranë dhe 6 në Prishtinë. Në 1971 dhe 1979 janë botuar nga 23 tituj, aq sa qenë botuar në katër dhjetëvjeçarët e parë të shekullit XX. Poezia vazhdon të ketë epërsinë e titujve në krahasim me romanin, 2/1. (Poezia 473, romani 256). Romani ka epërsinë e lexueshmërisë, sipas tirazhit, 6/1 (në 21 vjet, 1970-1990, me një mesatare 12.000 me 2000/1900. Përllogaritja është bërë vetëm me botimet e Tiranës, sepse nuk kishim të dhënat e tirazhit për botimet e Prishtinës). Epërsia/hegjemonia e romanit ndryshon strukturën tradicionale të letërsisë shqipe. Nga strukturë e poezisë shndërrohet në strukturë të romanit, që është struktura moderne bashkëkohore e letërsive europiane me të cilat fillon të bashkëkohëzohet nëpërmjet këtij shndërrimi të brendshëm zhanror dhe, njëkohësisht, për herë të parë, bëhet e pranishme dhe e njohur mes tyre, e përkthyer në shumë gjuhë. Tipologjikisht janë lëvruar lloje të ndryshme: romani realist shoqëror, sagë, psikologjik, i realizmit socialist, historik romantik, biografi e romansuar, lloje dhe trajta të romanit modern dhe pasmodern, të alegorisë analogjike me përbërës të llojit fantastik, absurdes dhe paradoksit, antiutopisë, ironik, me strukturë mitike, anticipimit, etj.

Momenti i tretë janë dhjetëvjeçarët e shekullit XXI, i cili dallohet për larminë e zhanreve dhe poetikave rrëfimore realiste, moderne, moderniste e pasmoderne, të ndërthurrura e të harmonizuara, herë në shumësinë e veprës tërësore të një autori dhe, herë brenda të njëjtit roman. Si të thuhet, kjo është periudha e polizhanreve dhe polipoetikave. Ky tipar vërehet në romanet e Fatos Kongolit, Mehmet Krajës, Bashkim Shehut, Vath Koreshtit, Rexhep Qosjes, Zija Çelës, Zejnullah Rrahmanit, Agron Tufës, etj.

Romani polifonik *E zeza dhe e kuqja* i Mehmet Krajës është një sintezë e këtij tipari, që është përcaktues edhe i stilit të tij, të zhvilluar e pasuruar në vite. Në të janë ndërthurrur zhanre dhe përbërës të romanit psikologjik, sagë, ironik, fantastik, utopik, përsiatës filozofik, etj. me

trajtat e veta rrëfimore, realiste, ironike, fantastike, utopike, përsiatëse, lirike poetizuese, epiko-legjendare një sërë prej të cilave janë shndërruar në trajta të tjera, moderne e pasmoderne, që janë dhe zotëruese. Ndërkëmbimi i tyre ka përfutur shëmbëlltyrat e tri botëve të ndryshme, përballë a të mbivendosura. Njëra është shëmbëlltyra e jetës së njëmendët, atyre që ndodhin në përditshmëri dhe kanë ndodhur në histori, me konkretësi hapsinore mjediset e Krajës, buzë liqenit të Shkodrës, matanë kufirit politik, dhe në referencë kohore qindvjetshi 1912-2012. Dy janë shëmbëlltyra të botës mendimore psikologjike, të panjëmendëta, utopike, e vegimeve të dëshirave ëndërrore, dhe antiutopike, fantaziste e një bote të pëtejme të vdekjes. Natyrisht, do të ishte e vështirë, në mos e pamundur, të paraqiteshin me mjetet e kufizuara të një zhanri të caktuar, që do të thotë, se ndërthurjen e zhanreve dhe të poetikave nuk e ka zgjedhur thjesht autori si eksperiment, por e kanë kërkuar këndvështrimet e ndryshme për botën njerëzore, për rrjedhë, edhe brendia e pasur.

Ironia

Titulli *E zeza dhe e kuqja* është ironik, parodizim i titullit të romanit të Stendalit *E kuqja dhe e zeza*. Me këtë nyje zanafillore prej letërsisë, ironia zhvillohet për mosharmoninë mes ngjyrës së kuqe dhe të zezë, që janë ngjyrat e flamurit shqiptar, simbol i identitetit dhe i historisë. Rendi i tyre është e përmbysur dhe në një këndvështrim të kundërt. E para dhe zotëruese është e zeza, simbol i të keqes, mosharmonisë në analogji me moskuptimet, mosmarrëveshjet, paafësinë, mungesën e bashkëveprimit për të përballuar situatat qeniesore, dobësitë, veset, humbjet e shqiptarëve, të cilat janë objekti i romanit në këndvështrime të



Prof. Dr. Bashkim Kuçuku

ndryshme, në radhë të parë, ironik. E kuqja, apo, e mira, heroikja, virtyti, e arritura është dytësore. Romani është ironi e kundërvënies me mendësinë, letërsinë dhe historiografinë heroizuese shqiptare.

Saga e tjetërsuar

Ironia groteske, tipari përcaktues i stilit të Mehmet Krajës, në *E zeza dhe e kuqja* shpërfaqet nëpërmjet strukturës ndërkohore dhe ndërtekstore të sagës. Historitë e rrëfyera nga rrëfimtari autor për tre breza: gjyshin, të atin dhe veten shprehjen më të plotë të kohës një shekullorë nuk mund ta gjenin veçse te struktura e sagës me kohështrirjen e vijueshme më të madhe. Ato janë shtjelluar në tri pjesë të ndara, ose, në tre romane të njësuar, njëkohësisht dhe të mvehtësishtë. Nuk janë historitë e një familjeje të mbyllur në vetvete, ndonëse shpërfaqen mendësitë, traditat, zakonet, mënyra e jetesës, normat morale, veset, dobësitë, obsesionet, paranojat, marrëzitë, por janë bëmat e burrave të saj në marrëdhënie me problemin qeniesor identitar, në referencë me ngjarjet historike të vendosjes së dhunshme të kufirit shtetëror politik mes shqiptarëve dhe pasojat e tij (1912-2012). Kalimi nga problematika familjare në problematikë politike kombëtare është një nga kapërcimet e llojit të sagës. Edhe rënja e familjeve, ndryshe nga në sagë, ka ardhur nga shkaqe të jashtme politike dhe jo prej ndonjë krimi primordial të pjesëtarëve të saj. Gjyshi, i ati dhe i biri i tij rrëfimtari nuk ndëshkohen për padrejtësi e krime. Ata janë viktimat të padrejtësive politike të të tjerëve. Kështu, thelbi filozofik i sagës është tjetërsuar, në një këndvështrim të ri, me domethënie të tjera, politike. Me shndërrime të tilla problematike, mendimore dhe rrëfimtari, saga e Mehmet Krajës është shndërruar në një lloj sage pasmoderne. Prej saj janë ruajtur analizat e thella psikologjike, referenca ndaj ngjarjeve dhe figurave historike, karakterizimi i disa personazheve me mënyra e mjete realiste.

Antiutopia në botën e pëtejme

Të tri pjesët, apo, të tre romanet përmbillen me një njësi në formë epilogu, shëmbëlltyrë e një antiutopie në botën e pëtejme, e përcaktuar në përmasat kohore-hapsinore të pafundësisë dhe të asgjësë. Prej andej, hijet e personazheve, botën e të gjallëve prej nga kanë ardhur, e perceptojnë në këndvështrime të panjohura. Atje dalin nga errësira të fshehtat e tmerrshme, vrasjet prej ushtarëve dhe njerëzve të një pushteti të huaj, të cilat në jetën tokësore nuk i ka ditur kush dhe as ata mbi të cilët kanë rënë, prandaj, rrëfihen nga perspektiva e botës së pëtejme, ku nuk ka asgjë të fshehtë dhe vet fshehtësia nuk ka kuptim. Heronjtë, kur dëgjojnë makabritetet që u kanë ndodhur të tjerëve, ose, kur kuptojnë poshtërimin që u kanë bërë atyre të gjallët nxjerrin mbetjet nga zgavrat e syve për të humbur lidhjet me botën e të gjallëve. Mehmet Kraja për të shtrirë përmasat hiperbolike të negativizmit nëpërmjet absurdes, paradoksit dhe fantastikes shkon larg prej zhanrit të antiutopisë, që, zakonisht, sado e keqe, ndërtohet mbi tokë. Me peshën e rëndë të krimeve, të padrejtësive, prapësive njerëzore që zbulon, e zbret poshtë, nën tokë, me pohimin e nënkuptuar, se realiteti shoqëror është më i keq dhe jo thjesht ai që njohim, që shohim me sy e dëgjojmë me vesh.



110 VJET NGA KONGRESI I MANASTIRIT

110 vjet më parë gjuha shqipe vendosi themelin e saj, një alfabet të vetëm me 36 shkronja.

160 delegate e dijetare anembanë vendit, u mbledhën në 14 nëntor deri në 22 nëntor në Manastir të Maqedonisë, asokohe qendra e Vilajetit, për të përcaktuar alfabetin e gjuhës shqipe. Deri në këtë moment ishin hartuar disa alfabete ku një prej tyre ishte dhe ai i Stambollit. Por u hodh poshtë pasi shkronjat jolatine nuk ishin të përshtatshme për bashkimin kombëtar gjuhësor. Kryetari i kongresit u zgjodh Gjergj Fishta dhe sekretare Sevasti Qiriazi.

Ata dhe shume të tjere, kembengulen që gjuha shqipe të mos shkruhej as me shkronja arabe, as me shkronja greke, por në alfabetin latin, çka do të nënkuptonte mosnënshtrim ndaj otomaneve dhe grekeve. Me votë unanime kongresi vendosi që gjuha shqipe të shkruhej me alfabetin latin me 36 shkronja të cilat i përdorim edhe sot e kësaj dite.

110 vjet më parë gjuha shqipe vendosi themelin e saj, një alfabet të vetëm me 36 shkronja. 160 delegate e dijetare anembanë vendit, u mbledhën në 14 nëntor deri në 22 nëntor në Manastir të Maqedonisë, asokohe qendra e Vilajetit, për të përcaktuar alfabetin e gjuhës shqipe. Në këtë përvjetor, studiuesi David Hosaflook ekskluzivisht boton një broshurë ku zbulon origjinën e Himnit të alfabetit të dalë nga Kongresi i Parë të Manastirit duke bashkëpunuar dy institucione: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulture të Shqiptarëve – Shkup dhe Instituti për Studime Shqiptare dhe Protestante

110 vjet Kongresi i Manastirit

Zbulohet origjina e panjohur e Himnit të Alfabetit

Nga DAVID HOSAFLOOK

Kongresi i Manastirit (14–22 nëntor 1908) ishte ndër kuvendet më të rëndësishme në gjithë historinë politike dhe kulturore të kombit shqiptar. Çështja kryesore ishte njësimi përfundimtar i alfabetit shqip, i cili që i domosdoshëm për bashkimin e kombit.

Kur flitet për këtë kongres, emri i Parashqevi Qiriazi duhet të nderohet po aq sa edhe burrat e Komitetit. Si përfaqësuese e Shkollës së Vashave të Korçës, ajo ishte e vetmja delegate femër në Kongres. Ajo u zgjodh sekretarja e Komitetit, duke punuar gjithë ditën me të njëmbëdhjetët.²

Në vitin 1909, Parashqevia shkroi “Himnin e alfabetit”, botoi një abetare me alfabetin e ri, si edhe themeloi shoqërinë kombëtare për gra, “Yll” i Mëngjezit”. Më vonë, në Amerikë, ajo botoi një gazetë me të njëjtin emër (Yll i Mëngjezit, 1917–1920), e cila trajtonte tema patriotike, kulturore dhe arsimore për kontekstin shqiptar dhe amerikan.

Në pothuaj çdo numër botohej abecejë shqip, që të përhapej dhe të kuptohej. Deri tani, është hamendësuar se Parashqevia e ka kompozuar vetë Himnin e Alfabetit, ose se e ka huazuar nga një marsh francez. Por cila është origjina e vërtetë e kësaj muzike?

Në fillim të shek. XX, ndeshjet e futbollit amerikan midis kolegjeve rivale Yale dhe Harvard ishin shumë të forta. Para një ndeshjeje në vitin 1900, një student nga kolegji Yale, Allan M. Hirsh, krijoi një këngë frymëzuere me emrin “Boola” për të motivuar studentët dhe tifozët e tjerë të Yale-it. Teksti i këngës thoshte guximshëm se Yale-i do të fitonte thellë dhe lojtarët e dërrmuar të Harvard-it do të qanin: “Bula bula, bula bul”. Si melodi, Hirshi e përshtati këngën e tij prej një kënge

popullore me emrin “La Hoola Boola”, kompozuar nga muzikanti afrikano-amerikan Bob Cole. Me të vërtetë, kolegji Yale-i e fitoi ndeshjen 28–0.

Më 1905 kënga filloi të përdorej edhe nga Universiteti i Oklahomës dhe përdoret ende sot para ndeshjeve të tyre të sportit, me titullin: “Boomer Sooner”.


Midis viteve 1900–1901, këngës iu shtuan ca strofa të reja, jo më për sportin, por për vitet e shkollës, për krenarinë e të qenët student në Kolegjin Yale, për miqësitë që krijoheshin në kolegji, si edhe për besnikërinë që një student duhet të tregojë “ndaj Zotit, atdheut dhe Yale-it”, teksa largoheshin e niseshin për të punuar në “botën e turbullt si deti”.

Më 1904, Parashqevi Qiriazi, si edhe motra e saj e madhe Sevasti, u diplomua në një kolegji amerikan protestant për vajza në Stamboll, Constantinople Eömen’s College (Sevastia u diplomua më 1891). Duhet të hamendësojmë se pedagogët amerikanë të këtij kolegji e kishin sjellë në Stamboll këngën e Kolegjit Yale për të frymëzuar studentet, dhe se Parashqevi Qiriazi duhet ta ketë dëgjuar e kënduar këngën. “Adelina”, studente ideale e Kolegjit Yale në folklorin e kolegjit. Kur erdhi koha që Parashqevisë i duhej një muzikë e mirë për të frymëzuar shqiptarët për t’u bashkuar dhe për të ruajtur besën e dhënë në Kongresin e Manastirit, përballë trysnisë së krijuar nga xhonturqit, të cilët kundërshtonin alfabetin e ri, ajo e shfrytëzoi melodinë që ende oshtinte në kokën e saj prej vitesh, duke qenë e sigurt se kjo muzikë mund të këndohej lehtë dhe se do të kujtohej për një kohë të gjatë deri në ditët tona.

PARASHQEVI QIRIAZI, ME FJALËT E SAJ, PËR KONGRESIN E PARË TË MANASTIRIT DHE HIMNIN E ALFABETIT

Për në Kongresin e Parë të Manastirit Komisioni përgatitor ftoi edhe motrën time Sevasti të përfaqësonte shkollën shqipe të vajzave në Korçë. Vjeshtën e motit 1908, për shkak të rrethanave politike të krijuara me shpalljen e regjimit konstitucional në Turqi, shkolla jonë u çel me një numër shumë më të madh studentesh se sa në vjetët e robërisë. Puna e shumë për të zmadhuar shkollën dhe internatin e penguan drejtoreshën të largohet prandaj ajo ma delegoi mua të drejtën e mandatin për të përfaqësuar shkollën e vajzave të Korçës në këtë Kongres të Parë Kombëtar, sikundër u quajt atëhere prej shqiptarëve. Si dihet, inisiativen e mori Kllubi i Manastirit “Bashkimi”, i cili u themelua fill pas Hyrietit, dhe vella im Gjergj Qiriazi pati luajtur rolin kryesor. Qyteti i Korçës në këtë mbledhje të shënuar dërgoi përfaqësues, Mihal Gramenon, Gligor Cilkën, Sami Pojanin dhe Thoma Avramin. Si grua që isha nuk munda të udhëtoja vetëm, pra mora shoqen time Fillomenen A. Bonoti të më shoqëronte n’atë mision i [...]. Nuk do të flas këtu mbi vështirësitë ... [që] paten hasur im vella Gjerasim me motrën Sevasti, për të çelur shkollën shqipe të vajzave e për ta mbajtur hapur njëzet vjet me radhë gjatë sundimit tiranik të Sulltan Hamitit. Përpara shpalljes së Hyrietit shkollat shqipe nuk mundën të vazhdojnë pa ndërprerje as për djemt e të krishterëve, dhe sa për djemt e mohamedanëve, atyre u qe ndaluar kateqoresisht të mësonin shkrim e këndim në gjuhën amtare.

Dhe vete me mësueset e shkollës kur delnim nga



shkolla, Mitropoliti grek porositi rrugaçët të na shanin “Masonka, Protestante, Papiste” me gjithë se nuk ishim asgjë tjetër veç se shqiptare patriotë. Në një kohë të këtillë, pra, kur sundonin kushte barbare për femrat, pa të drejta politike për ato, dhe gratë muhamedane në rrugë s’mund të delnin pa ferexhe. Plotësisht e pa mundur dhe e pa dëgjuar që një grua të delte sheshit në një kongres burrash. ...

Im vëlla Gjergji që këshilltari kryesor i Klubit “Bashkimi” dhe inisiator kryesor i Kongresit, ai më keshilloi të mos ekspozohesha në Kongres e të mos dilnja në tribunë. Ai që burrë i urtë dhe i mençur dhe me kulturën e tij të gjerë kish fituar simpatinë e miqve të Shqipërisë edhe

mund të them respektin e të huajve.

Me gjithë këto pengesa mua prapë mu dha një rast i mirë të shërbenj në Komisionin që zgjodhi Kongresi për të caktuar abecenë. Ky komision i bënte mbledhjet në shtëpi të Gjergj Qiriazit i cili që edhe kryetar i tij. Nëna jone, Maria, ishte e pamundur, por unë ndihmoja zonjen e Gjergjit për të pritur e përcjellë ... anëtarët e komisionit të cilët punonin me ditë të tëra të veçuar për të shikuar çështjen e alfabetit, por edhe dhashë dorë duke mbajtur shënime për Komisionin.

Por puna ime gjatë Kongresit që efemere [d.m.th. “që nuk zgjat më shumë se një ditë”, D.H.]. Ajo që mbeti në formë konkrete dhe e dobishme prej dorës sime, punë e frymëzuar prej Kongresit të Parë të Manastirit, është botimi i abetares sime të hartuar sipas rregullave që

vendosi Kongresi vetë. Kjo abetare, e para e llojit të saj, doli pas disa muajve dhe u lajmua prej shtypit kombëtar si një punë e vlefshme. “Bashkimi Kombëtar” me 5 të Vjeshtësë Tretë 1909 shkruante: “Kjo libër e vogël me 32 faqe dhe me 18 fytira është radhitur bukur e pas [...] me abecenë që vendosi Kongresi i Manastirit”. Abetarja vërtet mbajti çmimin 20 para copa por e vërtete është se ajo u shpërnda gratis jo vetëm të [...] por edhe në gjithë nxënësit e shkollave shqipe të atëhershme.

Që në Kongresin e Manastirit turqit edhe grekërit treguan planet e tyre ndaj shqiptarëve. Bënë çmos që të merret alfabeti arab edhe grek për të shkruar gjuhën shqipe.

Për të luftuar punën e vlefshme të Kongresit të Parë të Manastirit dhe për të penguar mbrohtësinë e popullit shqiptar t’arsyer me gjuhën amtare, xhonturqit nisën fushatën kundër abecesë shqipe duke botuar një abetare të tyre me shkronja arabe. E zemëruar nga kjo punë e keqe e xhonturqvet kundër abecesë aty për aty shkrova himnin e alfabetit kombëtar i cili u këndua në katër anë të Shqipërisë më 1909:

Sot është’ dita shqipëtare

të përpigemi

Alfabetin ton’ të mbrojmë,

Shpejto burrani.

Shkronjat tona jan’ të arta,

Këto duamë.

Refreni:

Shqipëri, atdhe i dashur

Ne s’të lemë ty të varfër.

Shkronjat ton’ kanë

për të mbrojtur

Me gjithë shpirt shqipëtarisht.

2.

Arëmiqtë o shqipëtarë

po përpigënë

Shkronjat turçe dhe gërqishte

Të na japinë.

Le t’i mbajnë ato për vete,

Kemi tonatë.

3.

Ata duan shqiptarë ndarjenë tonë.

Këtë punë shumë kthjellët

e treguanë.

Ngrihuni pra t’u tregoni

se ju s’i ndroni

Udhëtimi nga Korça për në Manastir e bëme atë kohë me dy ditë. Nuk më del nga mendja nata që ngrysënë në han të Stenjës. Katër burra dhe dy gra në një kthinë trualli pa tavan e pa oxhak. Me rrobat e udhës e me pallton e madh krahëvet u mblodhëm të gjithë rreth zjarrit të ndezur në mes të vatrës me tymin që ntrashej sa me shumë, se s’kish nga të dilte.

Natën e gdhime me biseda kombëtare dhe rreth çështjes abecesë dhe herë-here duke dëgjuar ndonjë shaka prej xha Mihalit [Grameno] i cili ndërsa dërdhnim lot prej tymit, përpigje të na bënte të qeshnim. Kur arrimë në Manastir një ditë para se të çelej Kongresi qemë pa gjumë e të lodhur prej udhës.

Edhe ky udhëtim edhe Kongresi vetë më shtynë të mendohem se ç’duhej bërë për ta shpëtuar gruan nga gjendja në të cilën kredhej. Përveç Abetares dhe Himnit të Alfabetit, vendosa ashtu e heshtur, që kur të kthehesha në Korçë, të ftonja shoqet e mija të qytetit dhe së bashku të fillonim organizimin e një shoqërie kombëtare për gruan. Brenda vitit e themeluam, me emrin “Yll’i Mëngjezit” me qendër në Korçë edhe me degë nepër qytetet e tjera të Shqipërisë.

Parashqevi Qiriaz

Nga datat 8-9 nëntor u mbajt në Vienë panairi i ndërkombëtar i librit, në Vjenë, me Shqipëria në fokus, paraqiti tre autorë shqiptarë: Agron Tufa, Arian Leka dhe Lindita Arapi

SHQIPËRIA NË FOKUS

TUFA, LEKA DHE ARAPI PËR LETËRSINË SHQIPTARE NË VJENË

“Shqipëria në fokus” - Letërsia shqiptare vjen në Panairin Ndërkombëtar të Librit në Vjenë, Buchëien 2018, me 8 e 9 nëntor, me 4 autorë e përkthyes shqiptarë në bashkëpunim me Traduki. Traduki është një rrjet evropian për letërsinë dhe librat, ku marrin pjesë vende të Evropës dhe të rajonit juglindor të Evropës, i cili mbështetet shkëmbimin letrar nëpërmjet një programi përkthimesh nga letërsia, libra eseistike si dhe libra për fëmijë e të rinj.

Letërsia bashkëkohore shqiptare u përfaqësua me shkrimtarin Agron Tufa i cili prezantoi tekste të reja duke folur për trashëgiminë e vështirë të Shqipërisë dhe sfidat për punonjësit e kulturës në vendin e tij; eseisti Arian Leka paraqeti fragmente tekstesh dhe tregoi për zhvillimin e ri letrar në Shqipëri dhe jetën letrare në Tiranë; “Nga Durrësi në Vjenë”- shkrimtari shqiptaro-austriak Ilir Ferra paraqeti një tekst të ri rreth pritjes së refugjatëve hebrej në Shqipëri; Lindita Arapi lexoi pjesë nga romani i saj i cili ka fituar disa çmime “Vajzat me çelës në qafë”, i botuar edhe në gjermanisht “Schlüsselmadchen” duke ndarë përgjatë një bisede mbi imazhin e Shqipërisë në botën gjermanofolëse.

TEATËR

REALITETI I SOTËM SHQIPTAR I MBETUR “JASHTË DERËS” SË BORHERT

Nga ERMIRA GJATA

Para dy javësh, në kohë drekë, në oborrin e teatritit Kombëtar Eksperimental shoh disa aktorë të rinj që kishin qëndruar përpara projektorit të madh të protestës së përnatshme që vazhdon kundër prishjes së godinës së teatrit. Ata po bënin pushimimin e provave, me sa dukej, dhe papritur dëgjova që dikush prej tyre lëshoi një britmë dhe përsëri vazhdoi biseda. Kur u afrova, në mes të fytyrave të njohura të ish studentëve të mi, pashë dhe një djalë të ri që menjëherë më kujtoi Capajevin tek filmi rus Capajev. Ishte ai që kishte thirrur, regjisorin e ri lituanes që m'u duk si student. Aktorët e rinj më vunë në dijeni që pikërisht ky djalë 26 vjeçar ishte regjisorin që po punonte me ta për të vënë në skenë dramën e Wolfgang Borhert, “Jashtë derës”. Me thënë të drejtën e pashë me dyshim dhe vazhdova në punën time.

Por kur e pashë shfaqjen mora një leksion të mirë profesional, pikërisht nga “djaloshi”, pasi ai me konceptin dhe filozofinë e vënies në skenë të pjesës më tregoi se ishte në të vërtetë një regjisor i pjekur dhe i talentuar. Më pëqleu shfaqja pikërisht mbi këndvështrimin e trajtimit regjisorial. Regjisorin merr një pjesë që flet për luftën e dytë botërore, dhe duke përdorur satirën e sjell në ditët e sotme. Drama “Jashtë derës” e V. Borhert është shkruar nga një autor i ri gjerman që vdiq në moshën 26 vjeçare. Vetë autori ka marrë pjesë në luftë gjatë kohës së nazizmit dhe është plagosur. Për mendimet e tij të shprehura kunder luftës së kohës dhe për vlerat e vërteta humane, ai edhe u dënua me burg. Por, duke mos dashur të qëndroj shumë tek autori, por tek krijuesit e sotëm, që e vunë në skenë e teatrit shqiptar po përqëndroj shkrimin tim pikërisht tek spektakli teatror. Drama flet për një burrë, që pas disa vitesh pjesmarrës në luftë kthehet në shtëpi, por nuk është më ai i pari. Tmerret, vrasjet, masakrat e luftës kanë lënë gjurmë aq të thella tek ai sa e bëjnë të përjetojë makthe të tmerrshme dhe t'i largojnë qetësinë. Dhe ai përpëlitet ndërmjet ëndërrës dhe realitetit. Kërkon të vijë në shtëpi, por në përpjekjet e tij për të thënë të vërtetën dhe të clirohet nga ankthi, nuk gjen dot njerëzit që ta kuptojnë. Askush nuk e merr seriozisht, përveç Tjetrit, që është vetja e tij e dytë, personi optimist që lufton për ta parë realitetin me sy pozitiv dhe ta nxjerrë nga rrjeta e manktheve. Ushtari Bekman shkon dhe takon Elbën, një prostitutë që e ka njohur dikur, por që tani ajo i përplas në fytyrë realitetin e hidhur të kutërbimit të jetës së saj së shkatërruar nga lufta, që e ka transformuar në njeri të ashpër dhe pa sensibilitet. Ajo nuk e pranon dobësinë e tij dhe i sillet ashpër, duke e mbyllur monologun e saj...”unë e dhjes vetëvrasjen tënde...” Bekmani ikën i zhgënjyer dhe akoma më i frustruar nga makthi i thënies së të vërtetës dhe pesha e përgjegjesisë së kryerjes së detyrës. Është pikërisht, Tjetri që një moment e merr situatën në dorë, duke i hapur një dritare shprese. Të heqë përgjegjësinë e vrasjes së 20 burrave të një kompanie gjatë një beteje që ai drejtonte. Dhe këtë përgjegjësi t'ja “kthejë” kolonelit që e urdhëroi. Ushtari shkon tek shtëpia e kolonelit dhe e gjen, duke festuar gjithë gaz e hare ditëlindjen e vajzës së tij. Pa ja përtuar, ashtu, me një kupë gjuri të lënë në betejë, I lagur nga shiu dhe i zhelosur ai fillon të flasë për përgjegjësinë, që duhet të mbajë pikërisht ai kolonel,

për kufomat e burrave që ranë në luftë. Koloneli e sheh si të lajthitur dhe i mësuar me ngjarje të tilla, ruan qetësinë, e merr me të mirë dhe i mbush mendjen që të merret me teatër, pasi “aktron shumë bukur”. Drejtori i një teatri varieteteje e pranon ta shohë ushtarin. Dhe ushtari shpalos performancën e tij, që peshon sa e vërteta e hidhur që mbart mbi supë. Por drejtori i thotë se njerëzit nuk kanë nevojë për të vërtetën, “kush do t'ja dëgjojë sot, emrin e së vërtetës?”. Bekmani përpiet ta gjejë shpëtimin tek femrat. Por vajza që burri ju ka vrarë në luftën e Stalingradit, i thërret “peshk”, pasi e gjeti të lagur e bërë qull nga shiu. Dhe ajo nuk arrin t'ja heqë ankthet, edhe pse përpiqet që ta bëjë sa më të “lumtur” në mënyrën e saj femërore. Dhe ajo është pjesë e një realiteti të zymtë e pa shpresa. Më në fund Bekmani arrin në shtëpinë e tij, por atë e ka pushtuar zonja Kramer, e cila me paturpësi ja përplas derën në fytyrë, duke i thënë se prindërit i kanë vdekur dhe ai s'i përket më asaj shtëpie, pasi jeton vetë tani. Ajo e le jashtë derë. Në fund, pas shumë përpjekjesh, edhe Tjetri, “dorëzohet” përpara shpartallimit të së vërtetës dhe sëbashku me Bekmanin vetëvriten. Spektakli të fut gradualisht në udhën e tij plot emocion e të papritura. Fillon me aktorët të ulur në avanskenë përballë publikut, veshur me rroba të zakonshme. Si një bisedë që sikur po vazhdon, aktorët, thjeshtë rrëfejnë sejcili nga një histori personale të përjetuar në periudha të ndryshme të jetës. Pas monologjeve të tyre mbyllen dritat dhe fillon një muzikë e rëndë e shoqëruar me zë bariton burrash që të emocionon. Është një kor murgjish rusë që këndojnë me dhimbje. Gradualisht duken disa ekrane ku shihen pjesë të kaluara të historisë sonë në kohën e diktaturës, vetë diktatori nëpër tribuna, ushtarë të rinj që parakalojnë përpara tribunës së socializmit, krisma armësh, djegie, flakë, një murg që digjet, etj. Kur hapen dritat shohim Bekmanin që e hedhin në një gropë me ujë të mbushur nga shiu. Gropa ngjan herë si bunker, herë si llogore, herë si vend ku hidhen të gjitha të pëgërat njerëzore, herë si varrezë, herë si gropë ndërgjegje njerëzore. Regjisorin vendos lart gropës këmbët pa jetë të ushtarëve dhe nëpër to ecin Drejtori dhe Tjetri. Bekmani qëndron në fund të gropës dhe përpiqet të dalë jashtë saj, por herë kufomat e ushtarëve të vrarë që i ngrihen si mankthe, herë pamundësia e tij fizike, që nuk ka një kupë gjuri, pasi është plagosur në luftë, nuk e bëjnë të mundur. Dialogu bëhet më aktiv dhe lëvizjet e personazheve e shtojnë akoma më shumë emocionin e gjendjes së rënduar të heroit kryesor. Sipër gropës- bunker, apo llogore, qëndrojnë personazhet e tjerë me të cilët komunikon Bekmani. Ai i sheh nga poshtë, lakuriq, ashtu sic janë në të vërtetë, pa rroba, pa zbulurime, duke zbuluar paturpësinë e tyre. Ndërsa ata e shohin nga lart, si të mjerë dhe të besdishëm, që i shqetson me të vërtetat e tij “bajate”. Regjisorin e sheh dramën si pretekst për të dhënë qëllimin e tij ironizues, duke hequr një paralele me njeriun e sotëm të frustruar nga stresi i të ardhurës në rrjesht. Nuk ka qenë rastësi që ky i ri 26 vjeçar gjen një pjesë të një të riu që ka vdekur 26 vjeç dhe e sjellë në skenë në ditët e sotme pikërisht në një vend që ka vuajtur diktaturë të egër, pasojat e së cilës ndjehen akoma. Shfaqja merr përmasat filozofiko-shoqërore dhe ka një gjuhë të zgjedhur poetike, që shumë herë nuk thuhet me fjalë, por me veprimet fizike



të personazheve. Regjisorin Mantas Janciauskas ka bërë një punë thellësisht profesionale, elegante dhe plot emocion, duke e parë pjesën e V. Borhertit në një kënd fshikullues satirik e bashkëkohor. Për të ka shumë rëndësi që shfaqja të harmonizojë në funksion të idesë lojën e aktorëve me elementet e tjerë përbërës, duke na dhënë një shfaqje teatri që të godet emocionalisht, por dhe të bën të mendosh e “ta marrësh” me vete e të “jetosh” ca kohë me të. Dhe muzika e shfaqjes e krijuar nga vetë regjisorin është mjaft funksionale dhe përcjell evidentime të fuqishme emocionale. Po ashtu regjisorin ka punuar dhe me koreografinë e grupit të djemve që theksonte me masë idenë e shfaqjes. Aktorët janë të qartë dhe veprojnë lirshëm, natyrshëm, me një lojë interpretative jashtëzakonisht realiste dhe aq konkrete, sa të duket se gjithshka që luhet në skenë po ndodh aty për herë të parë. Bekmani i interpretuar nga Endri Cela, është një njeri i thjeshtë, i frustruar e lodhur që me një lojë mjaft të natyrshme përpiqet të japë një individ që lufton me ndershmëri dhe mish e shpirt për të mbijetuar nga gjithë mizeria ku e ka futur megalomania e njerëzve pushtetarë. Endri-Bekman përballon me profesionalizëm detyrat skenike dhe arrin të realizojë një figurë komplekse në të gjitha aspektet psikofizike, duke e bërë spektatorin pjesmarrës aktiv në gjithë luftën e përpjekjet e tij për të mbijetuar. Dhe tek Endri-Bekman spektatori sheh një pjesë të vetes së tij ndaj e përkrah në heshtje dhe merr pjesë emocionalisht në veprimet e tij. Herë të vjen keq, herë të vjen për të qeshur, herë të vjen për të thërritur kur sheh Bekmanin e Endrit në skenë. Tjetri, interpretuar me profesionalizëm nga Dasara Xhangolli është një personazh simpatik i shfaqjes që përpiqet të ngjallë tek Bekmani dashuri dhe optimizëm. Tjetri-Dasara, bëhet nxitës dhe veprues shumë i zellshëm, duke i hapur “dritare” shprese protagonistit, që shpesh e kap dëshpërimi dhe vuajtja. Aktorja Ardiana Tolka, që luan dhe tre personazhe, Elbën, Gruan e kolonelit dhe Zonjën Kramer ka punuar këndshëm dhe me finesë për të dalluar sejcilin rol, në bazë të veprimit skenik e të kërkesave regjisoriale. Por më shumë në lojën e saj spikat zonja Kramër, për elegancën, zhdërvjellhtësinë plastike të personazhit, mënyrën e komunikimit direct, pa artifica të tepërta, duke ja përplasur derën në fytyrë Bekmanit dhe e le jashtë. Romir Zalla- Koloneli, është një personazh që përfaqson elitën e shoqërisë, që me marifetet plot lustra të jashme, duke e “veshur” figurën



me petkun e njeriut babaxhan që të kupton e dëgjon dhe me shumë mjeshtri profesionale del deri tek tallja dhe përbuzja. Dhe në fund, kur Bekmani vjen t'ja kthejë përgjegjësinë, ai me cinizmin e arrogancën e tij e hedh jashtë duke e quajtur “aktor e sharlatan”. Drejtori i estradës, interpretuar me finesë nga Mehmet Xhelili është një tjetër personazh sharmant i shfaqjes. Me mënyrën e tij plot elokuencë në të folur dhe duke u kapur pas sloganeve dhe me shtirjen prej të rafinuari bëhet qesharak dhe i neveritshëm. Ilirda Bejleri në rolin e Vajzës është një personazh mjaft interesant dhe kompleks, që kërkon të shpëtojë për një moment Bekmanin, duke e marrë në krahët e saj të ngrohtë fem ërorë, por dhe që bie dhe ajo viktimë e rrethanave të maktheve. Vajza- Iridë është e fuqishme, plot epsh dhe njëkohësisht e mjeruar në shpirt. Aktorja ka paraqitur një personazh mjaft emocionant që i jep dinjitet shfaqjes. Algiona Aga, në rolin e vajzës së kolonelit, është e këndshme, elegante dhe plot emocion. Edhe pse ka pak vend në pjesë ajo le gjurmë në kujtesën e spektatorëve për mënyrën e paraqitjes së peronazhit të saj. Aktori i ri Mateo Dervishi duket që është përpjekur të japë një dhëndërr që mbështet të vjehrrin dhe mospërfillës ndaj veprimeve të Bekmanit. Për t'u përgëzuar është puna e grupit studentor të shfaqjes, që shoqërojnë gjatë gjithë kohës Bekmanin në skenë me lëvizje të ndryshme fizike, që janë në funksion të idesë së regjisë. Djemtë, me saktësinë e veprimeve, me angazhimin dhe përkushtimin bëhen pjesë e rëndësishme e shfaqjes, duke qëndruar si kurorë brilante e performancës teatrore. Ata janë: Digert Mataj, Klejdi Metaj, Julian Hurdha, Kleivert Ibrahimllari, Anxhelo Shkreli, Paolo Kadillari dhe Denard Neziri.

Regjisori solli një shfaqje të goditur bashkëkohore, të qëndisur me elemente e detaje mjaft interesante, që së bashku me skenografinë e Beqo Manaj dhe kostumografinë elegante të Sofi Karaj, krijuan një harmoni dinjitoze tatrore, që do të mbetet në mendje për shumë kohë e meson prej saj. Për t'u përmendur dhe lëvdur është edhe puna e as/regjisores Dajana Nenaj, e cila ka bërë dhe rolin e përkthyeses gjatë punës. Falenderoj punën e drejtuesve të Teatrit Kombëtar Eksperimental për sjelljen here pas here të regjisorëve të huaj e të talentuar, gjë që u shërben shumë komuniteti të aktorëve dhe regjisorëve tanë.



Djemtë, me saktësinë e veprimeve, me angazhimin dhe përkushtimin bëhen pjesë e rëndësishme e shfaqjes, duke qëndruar si kurorë brilante e performancës teatrore. Ata janë: Digert Mataj, Klejdi Metaj, Julian Hurdha, Kleivert Ibrahimllari, Anxhelo Shkreli, Paolo Kadillari dhe Denard Neziri.

LETËRSIA SHQIPE DREJT EUROPËS


FRANCEZËT LEXOJNË “VETMINË” E RIDVAN DIBRËS

Nga Franca vjen një tjetër reagim interesant për përkthimin në frëngjisht të “Legjendës së vetmisë” të shkrimtarit Ridvan Dibra. Nga data 16-18 Nëntor përkthyesja Evelyne Noygues së bashku me shkrimtarin shqiptar kanë marrë pjesë në një takim letrar tek Maison de l’Unesco, në prezantimin e letërsisë shqiptare drejt Europës. “Frymëzuar nga një këngë e vjetër popullore, romani i Dibrës është një lexim i vetmisë, e mungesës së komunikimit në mes njerëzve, mizorisë së tyre, që vërtitet mes vdekjes dhe hakmarrjes. Vetëm një shkëlqim i zbehtë, dhe përsëri është i dëshpëruar, ndriçon fundin e kësaj historie shumë të errët. Me një tekst thellësisht personal, fjalët e fundit të librit të Ridvan Dibrës krijojnë një metaforë të egër rreth komunikimit të pamundur mes qenieve.



“MËNGJESE NË KAFE ROSTAND” E KADARESË NË SPANJISHT

Libri “Mëngjese në kafe Rostand” të shkrimtarit Ismail Kadare është përkthyer së fundi në gjuhën spanjolle, nga Maria Rocas Gonzalez. Në faqet e këtij libri kalojnë përvojat dhe kujtimet e shkrimtarit në Tiranë dhe Moskë, miqtë e rinisë duke simbolizuar traditën e vjetër të Kafeneve të Evropës Qëndrore dhe Ballkanike që kanë shërbyer si një pikë takimi për artin, kulturën dhe letërsinë dhe një vend për të debatuar për çështje të përditshme.




BESNIK MUSTAJ NË ROMË PËR ROMANIN “NJË SAGË E VOGËL”



Së fundi është botuar në gjuhën italiane romani i Besnik Mustafaj “Një sagë e vogël”. Për të prezantuar librin, Mustafaj ishte i ftuar në Romë në një takim letrar për të prezantuar librin e tij me titullin “Piccola saga carceraria” ku morën pjesë emrat e njohur të letërsisë italiane dhe shqiptare.



BOTOHET NË FRANCË NJË TJETËR LIBËR ME PROZË NGA YLLJET ALIÇKA

Ylljet Aliçka është botuar sërish në Francë. Libri me tregime, “Tregime te dikurshme”, botuar nga shtëpia botuese Pyramidion et Chapitre douze ka hedhur në treg shkrimtarin shqiptar. Ne daljen e këtij libri botuesi shkruan ndër të tjera: “Me këtë vëllim të ri Ylljet Aliçka na zbulon çaste nga jeta e përditshme, ardhur nga një Shqipëri që kërkon të shkëpusë lidhjet e saja shpirtërore e politike me komunizmin.





PANAIRI I LIBRIT TIRANA 2018

